



USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 37 (827684)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 18 Shtator 2020

Presidenti Meta dekreton me grada madhore



Kolonelët Arben Kingji dhe Ilir Xhebexhia marrin gradën "Gjeneral Brigade"

Presidenti i Republikës dhe njëkosisht Komandant i Forcave të Armatosura z. Ilir Meta, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka, ka dekretuar kolonel Arben Kingjin me gradën madhore "Gjeneral Brigade". Me po të njëjtin propozim edhe kolonel Ilir Xhebexhia iu dha grada madhore "Gjeneral Brigade".

Kështu "në mbështetje të nenit 92, germa "d" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 3, germa "a", të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimin e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes...

» faqe 2

GJENERAL MAJOR BAJRAM BEGAJ

Bashkëpunimi ushtarak me Kosovën dhe Greqinë është në konsolidim të vazhdueshëm



» faqe 4

Partneriteti amerikano-shqiptar për mbrojtjen

Fillon projekti për rinovimin e strukturës për eliminimin e materialeve të rrezikshme

Shtetet e Bashkuara po punojnë me partnerët shqiptarë për të minimizuar rreziqet dhe ndikimet e mbetjeve eksplozive të luftës » faqe 3



Forca Detare

Përfundon stërvitja "GRUPEX 20". Certifikohen Grupet Patrulluese të Flotiljes Detare

Më datën 15 shtator 2020, në rajonin e Gjirit të Vlorës u zhvillua stërvitja GRUPEX 20. Kjo stërvitje kishte qëllim certifikimin e Grupeve Patrulluese të Flotiljes Detare. Në stërvitje morrën pjesë, përfaqësues nga shtabi i Forcës Detare, Shtabi i FDP-së, 6 anije të Grupit të I-rë dhe të II-të Patrullues, 1 skuadër e Grupit të Bordingut, gomonet...



» faqe 7

Në rajonin e Ver-Topit, Berat

Forcat Speciale zhvilluan stërvitjen "Tomorri-20"

Nga data 08-10 shtator 2020, kompania e III dhe IV e Aksioneve Speciale Direkte të Batalionit të Forcave Speciale zhvilloi stërvitjen "Tomorri-20" në rajonin e Ver-Topit, Berat. Kjo stërvitje u hartua në dy faza. Faza e parë, stërvitje mbi procedurat e planëzimit sipas procesit të vendimmarrjes ushtarake sipas standardit të NATO (MDMP) për Forcat Speciale, si dhe faza e dytë, planëzim dhe zgjidhje detyre konkrete në nivel task-grupi të...

» faqe 7

NË KAZERMËN "ADEM JASHARI" NË PRISHTINË

Gjermania jep donacione të rëndësishme për FSK

» faqe 10

SHSHPFARSH

Forca Tokësore është forca më e angazhuar brenda dhe jashtë vendit

» faqe 5

AUTOREË USHTARAKË

Zaim Kuçi dhe "Jeta e një piloti" në një libër

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ » faqe 6



Presidenti i Republikës dhe njëkosisht Komandant i Forcave të Armatosura z. Ilir Meta, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka, ka dekretuar kolonel Arben Kingjin me gradën madhore “Gjeneral Brigade”. Me po të njëjtin propozim edhe kolonel Ilir Xhebexhia iu dha grada madhore “Gjeneral Brigade”.

Kështu “në mbështetje të nenit 92, germa “d” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, dekretohet Kolonel Arben Voke Kingji, me detyrë “Komandant”, i Batalionit të Mbështetjes, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i jepet grada madhore “Gjeneral Brigade. Ky dekret hyn në fuqi menjëherë. Nr. i Dekretit 11703 Tiranë, më 11.09.2020”.

Nga ana tjetër “në mbështetje të nenit 92, germa “d” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, dekreton, “Kolonel Ilir Hasan Xhebexhia, me detyrë “Zëvendës Përfaqësues Ushtarak në NATO, Atashe Ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Belgjikë dhe jo-rezident në Francë”, në Përfaqësitë Ushtarake Jashtë Vendlit, i jepet grada madhore “Gjeneral Brigade”. Ky dekret hyn në fuqi menjëherë. Nr. i Dekretit 11704. Tiranë, më 11.09.2020”.

Kolonel Arben Kingji mban aktualisht detyrën e komandantit të Batalionit të Mbështetjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Gjeneral brigade Arben Kingji ka ushtruar edhe detyra të tjera si ajo e atasheut ushtarak të Republikës së Shqipërisë në Rumani. Me herët ai ka qenë edhe komandant i Policisë ushtarake. Ka kryer Kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes në



"Gjeneral Brigade" Arben Kingji



"Gjeneral Brigade" Ilir Xhebexhia

PRESIDENTI META DEKRETON ME GRADA MADHORE

Kolonelët Arben Kingji dhe Ilir Xhebexhia marrin gradën "Gjeneral Brigade"

Kolonel Arben Kingji mban aktualisht detyrën e komandantit të Batalionit të Mbështetjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.



Tiranë. Gjeneral brigade Kingji ka mbajtur detyrën e komandantit të kontigjentit në disa misione në Afganistan e Irak.

Në vitin 2016 ai përfundoi edhe

studimet për drejtësi në Winsdom University. Për kontributet e tij në Forcat e Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji është nderuar me disa medalje. Ai mban edhe

Kolonel Ilir Xhebexhia aktualisht mban detyrën e zëvendëspërfaqësuesit ushtarak në NATO, atashe ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Belgjikë dhe jo-rezident në Francë, në Përfaqësitë Ushtarake Jashtë Vendlit.

medaljen e Artë të Shqiponjës, dhënë nga Presidenti i Republikës.

Kolonel Ilir Xhebexhia aktualisht mban detyrën e zëvendëspërfaqësuesit ushtarak në NATO, atashe ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Belgjikë dhe jo-rezident në Francë, në Përfaqësitë Ushtarake Jashtë Vendlit. Ai ka përfunduar Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes. Ndërsa në 2006-2007 ka qenë oficer koordinator, pranë Komandës Qendrore Amerikane Tampa-Florida USA. Ai ka ushtruar edhe detyra si zëvendëskomandant i Qendrës së Radio-Zbulimit, nënkolonel, oficer Shtabi për Inteligjencën, Përfaqësia Ushtarake - Bruksel.

Ai ka marrë pjesë në disa misione ndërkombëtare si: stërvitja “Rescu-

er”, Maqedoni; oficer koordinator “Rescuer”, Maqedoni; misioni i SFOR-it në Bosnje-Hercegovinë; operacioni “Liria Irakut” (C-2 në CJTF-7) në Bagdad.

Në formimin e tij, tashmë gjeneral brigade Ilir Xhebexhia numëron edhe një sërë kursesh në Turqi, Gjermani, Greqi, Holandë. Gjatë karrierës së tij, gjeneral brigade Xhebexhia është vlerësuar me disa dekorata, përfshirë; “Medalja e NATO-s për Misionin e Paqeruajtjes” 1998, dhënë nga sekretari i Përgjithshëm i NATO. Ai botoi dy libra, “Liria e Irakut” në 2006 dhe “Evropa Juglindore Proceset Integruese” në 2007 dhe bashkëautor në disa botime të tjera.

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Gazetarë:
Saimir **ALIJA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”

Partneriteti amerikano-shqiptar për mbrojtjen

Fillon projekti për rinovimin e strukturës për eliminimin e materialeve të rrezikshme

Shtetet e Bashkuara po punojnë me partnerët shqiptarë për të minimizuar rreziqet dhe ndikimet e mbetjeve eksplozive të luftës

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka dhe ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, me 15 shtator 2020, kanë inspektuar punimet për rinovimin e strukturës speciale për eliminimin e materialeve të rrezikshme në Batalionin e Xhenios në Komandën Mbështetëse, një bashkëpunim me Departamentin e Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ambasadorja e SHBA ka vlerësuar kontributin që Shqipëria ka dhënë përmes efektivëve të saj të Forcave të Armatosura në misione të ndryshme në kuadër të NATO.

Ambasada e SHBA në Tiranë zbardhi detaje nga takimi i ambasadores Yuri Kim dhe ministren e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, gjatë inspektimit më 15 shtator të punimeve në depot e municionit.

Ambasada shkruan në 'Facebook' se Yuri Kim dhe ministrja Xhaçka kanë vizituar një prej projekteve të shumta për asgjësimin e municioneve në Shqipëri.

"Sot, Ambasadorja Kim dhe Ministri e Mbrojtjes Xhaçka, vizituan një prej projekteve të shumta për asgjësimin e municioneve në Shqipëri, drejtuar nga Zyra e Bashkëpunimit Ushtarak. Nën programin e Ndihmës Humanitare të Minave, të Komandës Evropiane të Sh.B.A. (EUCOM), Shtetet e Bashkuara po punojnë me partnerët shqiptarë për të minimizuar rreziqet dhe ndikimet e mbetjeve eksplozive të luftës. Ky është vetëm një shembull se si partneriteti amerikan-shqiptar për mbrojtjen po e bën Shqipërinë një vend më të sigurt për të jetuar", shkruan ambasada.

Nga ana e saj, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka nënvizoi faktin se SHBA, si aleat strategjik ka treguar se vazhdon të qendrojë krah për krah Shqipërisë për modernizimin e FA për më shumë siguri dhe profesionalizëm në fushën e Mbrojtjes.



Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, shkruan ne facebook se: "Krah për krah me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për rritjen e sigurisë në fushën e mbrojtjes. Me ambasatoren Yuri Kim sot inspektuam punimet për forcimin

e kapaciteteve dhe rritjen e masave të sigurisë, për depot e municionit në Batalionin Xhenio, në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Mbrojtjes.

Ky projekt, synon rritjen e ka-

pacitetit të Forcave tona të Armatosura për të kufizuar rrezikun e ngjarjeve shpërthyes dhe të devijimit të paligjshëm, të municioneve dhe materialeve shpërthyes. Mbështetja e aleatëve për FA është pasqyra më e

mirë e vlerësimit për Shqipërinë, si aleat i denjë dhe vend i sigurtë".

Në projekt parashikohet rinovimi për ruajtjen e sigurisë në Batalionin e Xhenios në Tiranë si edhe në depot e municionit në Mirakë, Elbasan.

OPERACIONI I NATO-S "RSM", AFGANISTAN"

Kohëzgjatja e misionit shqiptar është deri në 10 dhjetor 2021

Vendimi i Qeverisë Nr. 695, datë 9.9.2020 "Për një ndryshim në vendimin nr.513, date 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave "Per pjesmarrjen e nje toge kembesorie te Forcave te Armatosura te Republikes së Shqiperisë, në mission në Komanden e Trajnim-Keshillimit dhe ndihmës në Herat, në kuader te operacionit te NATO-s "RSM", Afganistan" është botuar në date 14 shtator në Fletoren Zyrtare nr.164, pra ka hyrë në fuqi.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi: 1. Fjalja e parë, e pikës 4, të vendimit nr. 513, datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon: "Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 10 dhjetor 2021.". 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. 3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



Gjeneral Major Bajram Begaj

Bashkëpunimi ushtarak me Kosovën dhe Greqinë është në konsolidim të vazhdueshëm

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi takime me atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, kolonel Bashkim Shillova dhe atasheun ushtarak të Republikës së Greqisë, kolonel Efthymios Ntallas, të akredituar në vendin tonë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi ditën e enjte që kaloi, më datë 10 shtator 2020, takime me atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, kolonel Bashkim Shillova dhe atasheun ushtarak të Republikës së Greqisë, kolonel Efthymios Ntallas, të akredituar në vendin tonë.

Gjeneralmajor Begaj, gjatë takimeve vlerësoi bashkëpunimin ushtarakë bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, atë rajonal edhe më tej, në kuadër të misionëve dhe aktiviteteve të NATO.

Në veçanti për bashkëpunimin me Forcën e Sigurisë së Kosovës, SHSHPFA gjatë takimit me atasheun ushtarak të Kosovës, kolonel Shillovën theksoi se: "Bashkëpunimi ushtarakë midis dy vendeve tona është në konsolidim të vazhdueshëm dhe i orientuar nga e ardhmja".

Më tej, u vlerësua bashkëpunimi në fushën e emergjencave, për të cilën gjeneralmajor Begaj përcolli falenderime edhe njëherë për kontributin e burrave dhe grave në uniformë të Forcës së Sigurisë të Kosovës gjatë situatës të krijuar nga tërmeti i vitit të kaluar.

Ndërsa për bashkëpunimin ushtarak me Forcat e Armatosura të Republikës së Greqisë, një nga fushat që u vlerësua gjatë takimit të SHSHPFA me kolonel Ntallas



ishte ajo e edukimit dhe trajnimit, ku shumë ushtarakë të Forcave të Armatosura shqiptare kanë ndjekur kurse të standardeve të NATO në institucionet ushtarake të Greqisë dhe anasjelltas, ushtarak të lartë të FA së Greqisë kanë qenë pjesë e vazhdueshme e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, e organizuar nga FARSH.

Gjithashtu, bashkëpunimi midis dy Forcave të Armatosura është i shtrirë në nivel NATO ku ushtarakët e dy vendeve shërbejnë sëbashku në operacionet dhe komandat e NATO.

Kolonel Shillova dhe kolonel Ntallas përcolli urimet nga titullarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Greqisë për marrjen e detyrës së shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH si dhe ndanë të njëjtin mendim për vijimin edhe në të ardhmen të bashkëpunimit ushtarak midis vendeve.

Gjeneralmajor Bajram Begaj takon ambasadorin e Turqisë, Ahmet Yörük

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj zhvilloi me 11 shtator 2020, një takim me ambasadorin e Republikës së Turqisë në Tiranë Murat Ahmet Yörük. Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj vlerësoi bashkëpunimin ushtarakë bilateral midis vendeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, atë rajonal por edhe më tej, në kuadër

të misionëve dhe aktiviteteve të NATO.

Në kuadër të asistencës për situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, SHSHP falënderoi palën turke për mbështetjen materiale me pajisje mjekësore.

Bashkëpunimi ushtarakë midis dy vendeve shtrihet në fushat e edukimit, trajnimit, shëndetësore, modernizimit dhe logjistike dhe misionëve

të NATO konkretisht kontingjenti i përbashkët ushtarak që shërben në Hamid Karzai International Airport, në Kabul, Afghanistan. Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë përcolli urimet nga titullarët e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Turqisë për marrjen e detyrës së SHSHP dhe vijueshmërinë e bashkëpunimit ushtarakë midis vendeve.



Ekspertët shqiptarë në Camp Adazi-Letoni



Sigurohen 1400 efektivë të NATO-s nga municionet e paplasura

Trupat e kontingjentit shqiptar në Letoni vijnë shërbimin në grup-batalionin e NATO-s në Camp Adazi, në përmbushje të detyrave ndaj Aleancës. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ndau me 11 shtator 2020 një video nga shërbimi i ekspertëve shqiptarë të bombave në Letoni, të cilët sipas saj, "mbajnë të sigurt 1400 efektivë të grup-batalionit të NATO-s nga municionet e plasura dhe të paplasura". "Ekspertët tanë të bombave në Letoni vijnë shërbimin, për të mbajtur të sigurt 1400 efektivë të grup-batalionit të NATO-s nga municionet e plasura dhe të paplasura në Camp Adazi. Ne jemi NATO", shkruan ministrja Xhaçka.

Policia Ushtarake është një strukturë e rëndësishme e FA

Duke vazhduar takimet me strukturat e Forcave të Armatosura, ditën e mërkurë më 16 shtator 2020, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, vijoi turin e takimeve në Batalionin e Policisë Ushtarake.

Në takimin me Batalionin e Policisë Ushtarake, SHSHPFA adresoi një falenderim për të gjithë efektivet e kësaj strukture për përkushtimin në kryerjen e detyrave, në veçanti për angazhimet dhe kontributin e dhënë në situatë të vështira në shërbim të komunitetit, si në tërmetin e Nëntorit, dhe veçanërisht për menaxhimin e situatës agresive të fillimit të pandemisë së COVID-19. Ndër të tjera u shpreh se: "Policia Ushtarake është një strukturë

e rëndësishme dhe e konsiderueshme e Forcave të Armatosura, në pikëpamje të detyrave dhe angazhimeve që ka, por edhe të misionit të saj specifik".

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj shprehu bindjen në përgjegjshmërinë dhe përkushtimin që do të tregojnë për kryerjen e detyrave dhe përballimin e vështirësive dhe sfidave, ashtu si kundër i siguroi ata për mbështetjen e Shtabit të Përgjithshëm në realizimin e të gjitha objektivave. Në mbyllje të takimit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH u njoh më nga afër edhe me ambientet e punës të Batalionin e Policisë Ushtarake.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral major Bajram Begaj

Forca Tokësore është forca më e angazhuar brenda dhe jashtë vendit

Prioriteti kryesor do të jetë zhvillimi i kapacitetit të Grup Batalionit të Këmbëorisë së Lehtë (GBKL) sipas paketës së Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral major Bajram Begaj zhvilloi me 15 shtator 2020, një takim njohës me strukturat e Komandës së Forcës Tokësore, ku u prit nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai.

Pas pritjes me ceremoni nderi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral major Bajram Begaj, nëpërmjet një prezantimi të mbajtur nga komandanti i kësaj force, u njoh me misionin, detyrat dhe angazhimet e Forcës Tokësore brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë prezantimit, ku ishin të pranishëm edhe shefat e degëve në Shtabin e Forcës Tokësore, Gjeneral major Begaj u njoh edhe me problematikat e hasura gjatë punës së përditshme të kësaj force.

Në fjalën e tij në këtë takim, SHSHPFA pasi i falënderoi për prezantimin e bërë, u shpreh:

"Unë jam sot këtu pikërisht për një njohje më nga afër me ju dhe me situatën e aktivitetin e forcës tuaj. Forca Tokësore është jo vetëm struktura më e madhe e Forcave të Armatosura, por njëkohësisht mbetet edhe forca më e angazhuar me detyra brenda dhe jashtë vendit. Sigurisht që unë jam në dijeni të këtij fakti, por prezantimi i paraqitur më shërbeu ta njohë gjendjen më në detaj".

Më tej gjatë fjalës së tij, gjeneral major Begaj adresoi një falënderim të veçantë për përkushtimin dhe kontributin që kjo forcë ka dhënë në situatë të vështira të vendit, sikurse ishte tërmeti i nëntorit, pandemia e COVID-19 dhe emergjencat civile. Ndër të tjera ai u shpreh:

"Mbi bazën e këtyre përvojave dhe mësimave të nxjerra, unë e kam orientuar punën dhe aktivitetin e Forcave të Armatosura drejt një vizioni të ri, me të cilin ju jeni njohur. Megjithatë, unë e vlerësoj të nevojshme të theksoj drejtpërdrejt me komandat dhe personelin e Forcave të Armatosura prioritetet



e punës time. Në këtë kuadër, prioriteti kryesor do të jetë zhvillimi i kapacitetit të Grup Batalionit të Këmbëorisë së Lehtë (GBKL) sipas paketës së Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s".

Në përfundim të fjalës së tij në takimin me Komandën e Forcës Tokësore, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH u shpreh se Forca Tokësore do të jetë prioriteti kryesor i Shtabit të Përgjithshëm dhe do të ketë mbështetjen e plotë në realizimin e misionit, projekteve të modernizimit dhe objektivave të kapaciteteve.

SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FARSH VIZITË NË FORCËN AJRORE

Forca Ajrore mban në gatishmëri kapacitetet ajrore të vendit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, vijoi turin e takimeve njohëse në Komandën e Forcës Ajrore. Në fjalën e tij në takimin e zhvilluar ditën emerkure, më 16 shtator 2020, me personelin e Forcës Ajrore SHSHPFA theksoi se "Forca Ajrore është një strukturë e rëndësishme jo vetëm për Forcat e Armatosura, por edhe për vendin. Kjo, jo thjesht për faktin se administron dhe mban në gatishmëri të gjitha kapacitetet ajrore të disa institucioneve të vendit, por për detyrat e veçanta, specifike, dhe në shumë raste, me vështirësi dhe rrezikshmëri të lartë që kryen".

Më tej gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Begaj, solli në vëmendje përkujdesjen, motivimin dhe vlerësimin e veçantë që ka patur dhe vijon të ketë personeli i Forcës Ajrore, veçanërisht pilotët, duke njohur një përmirësim të konsiderueshëm bazuar në ndryshimet e fundit në trajtimin financiar të tyre. SHSHPFA u ndal edhe në investimet që janë bërë dhe vijnë të bëhen në Komandën e Forcës Ajrore. "Nga ana tjetër, edhe investimi për ngritjen dhe modern-



izimin e sistemit të vëzhgimit të hapësirës ajrore, të bazës së Kuçovës, pajisja edhe me disa helikopterë të tjerë nga aleatët tanë, sikurse ju e dini, tregon vëmendjen e shtuar ndaj Forcës Ajrore", theksoi

gjeneralmajor prof. asoc. Begaj. Në mbyllje të takimit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH u njoh më nga afër edhe me ambientet e punës të Komandës së Forcës Ajrore.



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Një copëzë e jetës fluturuse të një ushtaraku

Libri "Jeta e një piloti" të autorit ushtarak Zaim Kuçi është një libër sa profesional aq dhe i frymëzuar për dashamirësit e aviacionit. Leximi i librit është i këndshëm dhe me shije artistike, ku autori falë kulturës dhe njohurive të gjera në fushën e aviacionit luftarak dhe civil, të mbërthen dhe të fut gjithmonë në ndodhi dhe ngjarje realie dhe të gërshetuara bukur me kohën. Gjatë leximit të librit futesh në botën e fluturimit, pasi aturi shumë natyrshëm të ka marrë me vete në kabinën e avionit luftarak, dhe këtë e ka bërë si një profesionisti aktiv i botës së qiejve. Në çdo faqe të librit ndesh me dashurinë e autorit për profesionin e tij, i cili e lidhi fatin e jetës me fatin dhe të ardhmen e armës së fuqishme të Aviacionit...

Mjaft bukur në libër autori Zaim Kuçi ka arritur të realizojë një balafaqim tëpërvojës së tij ushtarake me historinë e aviacionit shqiptar. Në të gjitha etapat e jetës së tij ushtarake ai ka ditur të vërë në dukje politikën e mbrojtjes, ka realizuar me mjeshtëri historinë e vet, duke qenë vet protagonist i saj dhe i armës së aviacionit shqiptar. Jetën e tij e nis që nga momenti që shkeli në auditoret ushtarake, shkollat, fluturimet me avion luftarak të llojeve të ndryshme, tregon ngjarje tepër thjeshtë por që jehojnë gjatë në memorie, tregon për arritje të fushës ushtarake, por dhe në diplomaci, ku u vlerësua nga Presidenti i Francës Nikola Sarkozy me medaljen "Kryqi i Urdhërit Kombëtar të Meritës". Nga njëri syth i librit në tjetrin ndeshim në formim akademik, në profesionalizmin, në intelektualizmin, në diplomatin e kohës duke na përshkruar plotësisht karakterin atdhetar, kolonelin pilot, dhe njeriun e mirë që natyrshëm dhe bindës, tregon të mirë dhe se çfarë duhej të ishte bërë më mirë. Në trazicionin e gjatë të Forcave të Armatosura dhe shqiptar, autori ka dhënë pilotin e pjekur, guximi për të provuar, avionin luftarak dhe rregullin ushtarak duke marrë suksesin, por dhe propozon për model zhvillimi të armës së aviacionit.

Libri vërtet është një copëzë e jetës fluturuse të një ushtaraku, ku gjen njohuri për mjetin fluturues, tregon si ishin avionët mig që pilotuan pilotët heronj të aviacionit, tregon shkëlqimi dhe venitjen e tyre. Ky libër është i një lloji të veçantë, del fenomeni, ngjarja, bukuria, informimi dhe mësimi, në çdo faqe ka emocion. Libri me modestinë e tij, autori ushtarak gjen veten dhe civil, të ul në kabinën e avionit dhe nis fluturimin në rrugën e jetës së pilotit Zaim Kuçi.

Fëmijëria dhe dëshira për pilot

Autori tregon se erdhi në jetë nga një familje modeste, as nga librat dhe as nga pasuria por nga ndershmëria. Librat i kërkoi për të gjetur pasurinë shpirtërore dhe jeta ja dhuroi ato... Fare pranë fshatit Drobonik të Beratit gjendej baza ajrore e Kuçovës. Fluturimi i avionëve mbi kokat e fëmijëve ishte kureshtje për ta. Fluturimi i avionit mbi fshat thekson

Autorë ushtarakë

Zaim Kuçi dhe "Jeta e një piloti" në një libër

Aviatori Zaim Kuçi është vlerësuar nga Presidenti i Francës Nikola Sarkozy me medaljen "Kryqi i Urdhërit Kombëtar të Meritës"



autori, ishte për mua një kënaqësi dhe e desha zhurmen e tij. Në Berat pashë një burrë në veshur me uniformën e fluturimit. Babai i tha, ky është piloti që na zhurmon mbi kokat tona. Piloti i përshëndeti dhe Zaimin i ngelën sytë tek kostumi i bukur i fluturimit. Duke filluar nga viti 1967, prej fshatit Drobonik kreu arsimin tetëvjeçar në shkollën "24 Maj" në Beratit duke bërë në ditë mbi dy orë rrugë. Me vështirësive shpesh e fillonte ditën duke tharë rrobat e trupit pranë sobës te salla e mësuesve. I kishte vënë vetes detyrë që të bëhej pilot...

Shkollat ushtarake që formonin dinjitetin e ushtarakëve

Në shtator 1971 nisi studimet në shkollën ushtarake "Skënderbej", cila vlerësohej si një privilegj, e krahasuar me vështirësitë e shkollës tetëvjeçare. U nis kështu një jetë ndryshe, në një shkollë me disiplinë të rreptë. Me programin mësimor të larmishëm, me një trupën pedagogjike të përzgjedhur, të përkushtuar, si ushtarakët dhe mësuesit civilë, formuan dinjitetin e oficerëve të ardhshëm. Kjo shkollë ishte përgatitje e madhe për të përballuar vështirësitë e ushtrisë. Ndërsa në shkollën e Lartë e Aviacionit, nisi dhe rrugëtim i vështirë, por me pasion dhe me guxim për fluturimin. Fluturimi shkruan autori është diçka ndryshe, është pak i njohur, ka emocion, është art mbi artin. Këtu mësoi se po e shijove fluturimin, ecën gjithnjë me sytë nga qielli. Libri flet, ngacmon dhe tregon në heshtje, jetë dhe histori fluturimesh. Të gjithë pilotët i ruajnë kujtimet e tyre në librezën e fluturimit, në kostumin e lartësisë dhe mbingarkesës... në maketet e avionit, në librezën shëndetësore, në lapsin e lidhur me spango, në bllokun e shënimeve që ishin të pranishme në kabinën e avionit çdo ditë fluturimi. Të gjitha

këto kanë vlera, sepse kanë djersë e lot nga qielli, janë gjurmë për të gjithë ata që kanë fluturuar.

Fluturimi i parë...

Pas një rrugëtimi dyvjeçar, formimi teorik, pune dhe ëndrrash përballë mjetit fluturues, vjen momenti final, hapi i guximshëm drejt qiellit. Mjaftuan 8-10 min fluturim dhe merr fund gjithçka, të shtjelluar mirë apo keq në qenien e studentit për pilot, një kohë e shkurtër e qëndrimi i vetmuar në ajër. Pasi ke bërë 60-70 fluturime me instruktorin dhe pilotët vlerësues erdhi dhe momenti i shumëpritur për të fluturuar vetëm. Autori thekson se në kufje ende dëgjon zërin e tij në ngritjen e parë në ajër: -566 më lejoni ngritjen vetëm. Nga ana tjetër dëgjohej ju lejoni ngritjen vetëm 566. Veshët i gumëzhitën 56666. Kthen kokën mbrapa për të parë instruktorin dhe kupton se ishte vetëm në kabinë. Emocione dhe për uljen në pistë. Drejtoi avionin në vendin e pritjes, instruktor Perlati, doktori dhe shokët vrapuan drejt avionit, erdhën nga kulla e drejtimit dhe pilotët drejtues të aviacionit. Student pilot Zaim Kuçi ishte i skuqur dhe në djersë... Ndjeu mall për prindrit dhe ju duk se i kishte pranë dhe ata po ëmbëlsoheshin me çokollatat e urimit të daljes vetëm në qiellin e Atdheut.

Fluturimi në avionin reaktiv Mig-15

Pas hedhjen me parashutë dhe pas një seleksionimi të rreptë në avionin Tip-61, në vitin e tretë akademik vijonte dhe përfundonte programin në avionin reaktiv. Shkolla përgatiste pilotët për të fluturuar në Mig-19/21. Selektimi ishte i rreptë, parashikues, pa alternativë vijuese. Diplomohej më i miri për të shkuar në regjimentet luftarake. Proven e kaloi në saj të instruktorit Kujtim Osmani dhe komandantit të katërshes, pilotit të talentuar Isa Arapi. Gjatë stazhit

njëvjeçar në avionin Mig-17, cilësia e fluturimeve u rrit dhe nuk i munguan vlerësimet nga komanda e skuadriljes, Pandeli Lëngu, Harilla Rebi, Viktor Vangjeli dhe Agim Balili. Me instruktor Gjergji Spaho ishim bërë shokë dhe shpesh thyenim disiplinën duke fluturuar në lartësi të vogla në Berat dhe në fshatin Drobonik ku kishte prindërit e tij. Gjatë studimeve në Akademinë e Aviacionit, përvehtësohen tipat e avionëve Jak 18, Mig-15 dhe Mig-17 dhe në fund të programit mori librezën e fluturimit me 490 fluturime, pjesë e programit të shkollës, e cila konsiderohej "sekret", sepse shënohej sasia, koha, lloji i fluturimit dhe rezultati i vlerësuar me notë. Autori tregon histori konkrete nga jeta në Akademinë e Forcave Ajrore kur fluturoi me avionin reaktiv Mig-17 në Kuçovë. Akademia i diplomonte studentët me titullin "Pilot Gjuajtës Bombardues" mbas një stazhi njëvjeçar në avionin Mig-17 duke finalizuar mbrojtjen e diplomës në Shkollën e Vlorës. Në libër përshkruhen dhe të veçantat e programit të shkollës, ku në të nuk mungonte përgatitja, formimi si lider ship për të shërbyer në strukturat drejtuese në Forcat Ajrore, por dhe zënia e vendit të merituar në strukturat e Ministrisë Mbrojtjes dhe SHP, kohë kur përfaqësimi pothuajse mungonte.

Rruga drejt ambasadës...

Në faqet e librit zënë vend dhe kujtime nga shoqëria civile dhe ushtarake, histori pilotësh, të bukura dhe të rrezikshme që ishin pjesë e profesionit të pilotit. Fati e deshi që piloti Zaim Kuçi të bënte fluturim me avionin Alpha-jet, Dijon Francë për 35 min. Me interes është dhe një syth ku trajtohet fluturimi dhe diplomacia, lojtarë të së njëjtës fushë. Të jesh diplomat i mirë, do të thotë që ta konsiderosh vërtet detyrë të vështirë, më të vështirë se pilotimi i avionit Mig.

Bazuar në eksperiencën e fituar në vite dhe formimin e tij jashtë vendit u zgjodh për detyrën Atashe i parë i Mbrojtjes, për të hapur misionin ushtarak pranë Ambasadave të RSH në Francë dhe në Portugali, misioni ushtarak i RSH në Paris që u hap për herë të parë më 5 shtator 2006. Autori thekson se e vlerësova detyrën jo vetëm si diplomaci ushtarak por një mundësi përfitimi ekonomik, një diplomaci të kujdesshme e sjell atë, e vlerësova si dekoratën më me vlerë të karrierës ushtarake, duke përfaqësuar atdheun në tempullin e diplomacisë botërore dhe gjeta kudo tek francezët mirësinë. Franca i'u përgjigj plotësisht nevojave të Shqipërisë me mbështetje të vazhdueshme të atasheut të mbrojtjes francez në Tiranë.

Njohje me autorin Zaim Kuçi

Libri "Jeta e një piloti ...", të tërheq sepse është shkruar bukur, me ndjenjë dhe sjell shumë kujtime nga koha e vështirë e fluturimeve. Perlat Nazaj, piloti instruktor thekson se Zaimi ishte një student i kujdesshëm, i singert, i apasionuar me avionin, studiues dhe kërkues që binte në sy. Me leximin e librit, unë fluturova përsëri me studentin tim në avionin Tip-61. U ndjeva mirë, i lumtur që ish studenti im ka arritur një karrierë brilante, i vlerësuar nga autoritetet e lartë evropiane dhe të vendit, njerëz të artit dhe të diplomacisë.

Zaim Kuçi ka përfunduar Shkollën e Lartë e Aviacionit dhe është diplomuar për "Pilot gjuajtës-bombardues", ka studiuar në Akademinë e Mbrojtjes, në Kolegjin Superior Gjitharmësh të Mbrojtjes dhe në Institutin e Lartë Aeronautik në Paris. Ka kryer kurse mujore dhe javore për Sigurinë dhe Mbrojtjen në SHBA, Hollandë, Hungari, Gjermani dhe Akademia Diplomatike Shqiptare në Tiranë. Karrierën ushtarake e nisi pilot në avionin me helikë Tip 61 (Jak), në avionët reaktiv Mig 15/17 dhe në avionin supersonik Mig-19 deri në shtator 1990. Ka ushtruar detyrat shef i Stërvitjes të Forcave Ajrore, shef i Shtabit të Bazës Ajrore në Kuçovë, zëvendëskomandant i Akademisë të Forcave Ajrore, pedagog në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, shef Sektorit i Strategjisë dhe Politikës afatgjatë të FA, këshilltar Ushtarak i Shefit të SHSHP të FA, atashe i Mbrojtjes në Paris/Lizbonë, koordinator/analist, Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Për punë dhe përkushtim ndaj detyrës ushtarake është vlerësuar nga Kuvendi Popullor me medaljen e "Shërbimit Ushtarak", si dhe nga MM për "Për Shërbime në Ministrinë e Mbrojtjes dhe SHSHP të FA" në vitin 2002, "Për Shërbime të Veçanta" SHSHP të FA në vitin 2003 dhe në vitin 2006, si dhe "Medalja e Karrierës" SHSHP të FA në vitin 2011.

Certifikohen Grupet Patrulluese të Flotiljes Detare

Përfundon stërvitja detare "GRUPEX 20"

Në stërvitje morën pjesë, përfaqesues nga shtabi i Forcës Detare, 6 anije të Grupit të I-rë dhe të II-të Patrullues, 1 skuadër e Grupit të Bordingut, gomonet e Anijeve të Klasit "Iliria dhe elementë të Mbështetjes Shëndetësore

Më datën 15 shtator 2020, në rajonin e gjirit të Vlorës u zhvillua stërvitja GRUPEX 20. Kjo stërvitje kishte qëllim certifikimin e Grupeve Patrullues të Flotiljes Detare. Në stërvitje morën pjesë, përfaqesues nga shtabi i Forcës Detare, Shtabi i FDP-së, 6 anije të Grupit të I-rë dhe të II-të Patrullues, 1 skuadër e Grupit të Bordingut, gomonet e Anijeve të Klasit Iliria dhe elementë të Mbështetjes Shëndetësore. Stërvitja zgjati 2 ditë dhe u finalizua me qitje luftarake.

Në ditën e parë u përpunuan operacione të përballimit të rrezikut asimetrik, operacione të Kërkim-Shpëtimit SAR, vendosja e anijeve në formacion, operacione MIO (zbatim ligjshmërie), bordim anije, njeriu në det, rimorkim i anijeve, etj. Në ditën e dytë, herët në mëngjes, në rajonin e vetulores, Karabarun, u zhvilluan dhe qitjet bregdetare me artilerinë e Anijeve.

Qitjet u zhvilluan në distance të ndryshme, sipas kalibrave që posedonte cdo anije. Morën pjesë anijët P-133, P-134, P-132, p-116, p-112 dhe P-02. Në kthim me anijet pjesmarrëse u zhvillua stërvitje ku u ripërpunuan elemente të stërvitjes së datës 15 shtator. Qitjet bregdetare dhe stërvitja me anijet u ndoqën nga afër nga Zv/komandanti i Forcës Detare, Kapiten i Rangut të I-rë Ferdinand Kreshpani. Në fund, zoti Kreshpani përgëzoi personelin pjesmarrës në këtë stërvitje dhe qitje për përkushtimin e treguar në realizimin e detyrave dhe objektivave të caktuara.



Forca Tokësore e angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve

Forca Tokësore është në gadishmëri të plotë me qëllim përballimin e çdo situatë të krijuar nga rënia e zjarreve. 60 efektivë të Forcës Tokësore dhe Komandës Mbështetëse i janë bashkuar mëngjesin e ditës së dielë, më 13 shtator 2020, efektivëve të zjarrfikësve për shuarjen e zjarrit në fshatin Priskë, në Tiranë. Edhe pse në një terren të thepisur, ata kanë bërë të mundur shuarjen e zjarrit, duke shmangur rrezikun për banorët.

Më 15 shtator, repartet e Forcës Tokësore i janë përgjigjur menjëherë situatës së krijuar nga zjarret në zonat e njësisë administrative Kolsh, fshati Manat, bashkia Lezhë. Me marrjen e sinjalit të emergjencës së rënies së zjarreve nga Qendra e Bashkuar Operacionale, repartet 1010 Vau i Dejës, Shkodër dhe reparti 1020 Tiranë kanë dërguar trupat e gatëshme në rajonin e Lezhës. Në këtë operacion u përfshinë 4 mjete dhe 40 trupa të pajisura me bazë materiale të dedikuara për shuarjen e zjarreve. Ky operacion vazhdoi pandërprerje ditën dhe natën, duke freskuar trupat e angazhuara në operacion.

Ndërkohë me 15 shtator një zjarr i madh ra gjatë natës në zonën e Kallmit, Durrës, ku për shuarjen e tij u angazhuan 3 automjete të



drejtorisë MZSH, 2 automjete të Portit dhe 1 automjet i Shijakut, me mbi 20 forca zjarrfikëse dhe 4 vullnetarë. Nga zjarri mësohet se janë djegur rreth 100 ha pisha dhe shkurre.

Në të njëjtën ditë është djegur sipërfaqe e tëra me ullinj e me pemë frutore në fshatin Kashar nr. 2, në vendin e quajtur "Pompas e ujit", ku zjarri kishte dalë jashtë kontrollit duke përfshirë sipërfaqe më të madhe. Menjëherë kanë shkuar në vendngjarje dhe falë veprimeve të shpejta kanë identifikuar dhe vënë në pranga autorin e zjarrvënies.

Policia e Tiranës njoftoi se ka arrestuar një 59-vjeçar në Kashar, pasi dyshohet se ka djegur sipërfaqe të tëra

me ullinj e me pemë frutore në Kashar. Sipas policisë, zjarri kishte përmasa të mëdha. Uniformat blu të kryeqytetit fton qytetarët të denoncojnë çdo rast paligjshmërie

Por në të njëjtën ditë zjarri, nuk ka dalë jashtë Tiranës dhe nga Kashari ka kaluar në Sauk, ku një zjarr i madh, shkaqet e rënies së të cilit nuk dihen ende raportohet se ka rënë në zonën e Saukut në kryeqytet. Qytetarët në panik dhe të shqetësuar pasi flakët po përhapen me shpejtësi, apelan për ndërhyrje.

Nërkohe me 16 shtator zjarr masiv përfshiu kurorën e gjelbër në Kodër Krastë në Elbasan ku mësohet se flakët kanë shkruar një sipërfaqe me pemë dhe shkurre. Në vendin e ngjarjes arrihen shume shpejt forca ushtarke, zjarrfikëset dhe forca të shumta të policisë ku dyshohet se ky zjarr ka qenë i qëllimshëm. Kujtojmë se këtë verë, në vendin tonë, pemë, shkurre e pyje janë shkruar, për shkak të zjarreve nga temperaturat e larta ose zjarrvëniet e qëllimshme. Në gatishmëri për shkak të kësaj situatë janë të gjitha repartet e Forcës Tokësore me qëllim përballimin e çdo situatë të krijuar nga rënia e zjarreve. Angazhimi i reparteve të Forcës Tokësore do të vazhdojë deri në përmirsimin e situatës së krijuar nga zjarret në Shqipëri.

Në rajonin e Ver-Topit, Berat



Forcat Speciale zhvilluan stërvitjen "Tomorri-20"

Listat e kontrollit ishin hartuar sipas doktrinës së përbashkët të NATO për operacionet speciale AJP 3.5 si dhe atyre të dala nga manuali i NATO për SOTG

Nga data 08-10 shtator 2020, kompania e III dhe IV e Aksioneve Speciale Direkte të Batalionit të Forcave Speciale zhvilloi stërvitjen "Tomorri-20" në rajonin e Ver-Topit, Berat. Kjo stërvitje u hartua në dy faza. Faza e parë, stërvitje mbi procedurat e planëzimit sipas procesit të vendimmarrjes ushtarake sipas standardit të NATO (MDMP) për Forcat Speciale, si dhe faza e dytë, planëzim dhe zgjidhje detyre konkrete në nivel task-grupi të operacioneve speciale SOTG. Për realizimin e kësaj stërvitje u angazhua shtabi i dy kompanive në rolin e SOTG. Gjatë planizimit u përdor koncepti i vlerësuesit të stërvitjes duke zbatuar listat e kontrollit për çdo fazë, hap, procedurën dhe veprime konkrete operacionale. Listat e kontrollit ishin hartuar sipas doktrinës së përbashkët të NATO për operacionet speciale AJP 3.5 si dhe atyre të dala nga manuali i NATO për SOTG. Pas përfundimit të stërvitjes u zhvillua analiza pas veprimit ku vlerësuesit, drejtuesit dhe pjesëmarrësit diskutuan se çfarë u bë mirë dhe çfarë nevojitet të përmirësohet sipas mësimave të nxjerra për tu integruar në programet e stërvitjes.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S JENS STOLTENBERG

NATO mirëpret fillimin e negociatave për paqen në Afganistan

NATO dhe partnerët e saj i mirëpresin përpjekjet për të arritur në këtë pikë dhe i nxisin të gjithë afganët që tani të shfrytëzojnë këtë mundësi për paqe

Më 12 shtator 2020, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg foli përmes një lidhjeje video në ceremoninë e hapjes së negociatave brenda-afgane të mbajtura në Doha, nën kryesinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Katarit. “Me fillimin e negociatave brenda-afgane, ne po hyjmë në një fazë të re të procesit të paqes të udhëhequr nga Afganistanet dhe në pronësi Afgane,” tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. “Afganët duan paqe dhe po kështu edhe bashkësisia ndërkombëtare, e cila ka mbështetur Afganistanin në këtë rrugë të gjatë dhe të vështirë,” shtoi ai.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi përpjekjet e gjata të kryera nga Aleatët e NATO-s dhe partnerët në Afganistan, në nëntëmbëdhjetë vitet e fundit, si dhe arritjet e bëra në vend, me ndihmën e NATO-s dhe pjesës tjetër të bashkësisë ndërkombëtare, dhe angazhimin të NATO-s për sigurinë afatgjatë të Afganistanit. “Shumë është sakrifikuar gjatë rrugës, nga afganët dhe trupat tona,” tha ai. “Këto sakrifica nuk u bënë kot; Afganistani nuk është më një strehë e sigurt për terroristët ndërkombëtarë; tani ka jetëgjatësi më të lartë dhe vdekshmëri më të ulët të fëmijëve; më shumë fëmijë në shkollë, përfshirë vajzat; një përfaqësim më i lartë i grave në të gjitha fushat e jetës publike; një skenë e gjallë mediatike; dhe forcat afgane të sigurisë profesionale, të afta dhe multi-etnike; bisedimet që fillojnë



sot duhet të ruajnë këto përfitime për të pasqyruar shpresat dhe dëshirat e të gjithë burrave dhe grave afgane; ne

tani po rregullojmë praninë e trupave tona në Afganistan për të mbështetur përpjekjet e paqes; në të njëjtën kohë,

ne mbetemi të përkushtuar në trajnimin dhe financimin e Forcave të Sigurisë Afgane për të ndihmuar në

mbrojtjen e popullit Afgan”, vuri në dukje Z. Stoltenberg.

NATO dhe partnerët e saj i mirëpresin përpjekjet për të arritur në këtë pikë dhe i nxisin të gjithë afganët që tani të shfrytëzojnë këtë mundësi për paqe. Në një deklaratë, ata theksuan se ata presin që Republika Islamike e Afganistanit dhe ekipet negociuese Talibanë të angazhohen në mënyrë konstruktive ndërsa kërkojnë të arrijnë një marrëveshje paqësore gjithëpërfshirëse që i jep fund dhunës dhe bazohet në përparimin e 19 viteve të fundit për të mbrojtur të drejtat e njeriut të të gjithë afganëve, veçanërisht të grave, fëmijëve dhe pakicave, mbështesin shtetin e së drejtës dhe sigurojnë që Afganistani të mos shërbejë më kurrë si një strehë e sigurt për terroristët. Ata gjithashtu riafirmuan angazhimin e tyre të gjatë për Afganistanin, popullin Afgan dhe forcat Afgane të sigurisë.

USHTRIA KOMBËTARE AFGANE

Akademia e Oficerëve diplomon oficerin e saj të 5000-të

Më 10 shtator 2020, Akademia e Oficerëve të Ushtrisë Kombëtare Afgane diplomoi oficerin e saj të 5000-të. Kjo përfaqëson një moment historik për akademinë ndërsa Qeveria e Afganistanit përgatitet të marrë kontrollin nga ekipi aktual i mentorimit i udhëhequr nga MB, mbështetur nga Misioni i Mbështetjes së Vendosur të udhëhequr nga NATO. Rreth 75% e oficerëve të Ushtrisë Kombëtare Afgane dhe Forcave Speciale janë diplomuar në Akademinë, e cila u themelua në vitin 2013. Rreth 6% e të diplomuarve janë gra. Kadetët femra janë integruar plotësisht në kurs, duke kaluar të njëjtat standarde të përzgjedhjes për të fituar vendin e tyre në akademi dhe duke punuar së bashku me homologët e tyre meshkuj si në klasë ashtu edhe gjatë ushtrimeve në fushën e betejës.

Që nga viti 2016, përpjekjet e drejtuara nga NATO për të trajnuar, këshilluar dhe ndihmuar forcat afgane janë përqendruar në ndërtimin e qëndrueshmërisë institucionale afatgjatë për akademinë, përmes një përdorimi progresiv të një qasjeje “train-the-trainer”, në vend që të mësojë rekrutët e rinj drejtpërdrejt. Personeli afgan tani drejton shkollën

me këshillime të nivelit institucional nga trupat nga vendet e NATO-s dhe partnerët operativë të Mbështetjes së Vendosur.

“Ju qëndroni për stabilitetin, shtetin e së drejtës dhe barazinë për të gjithë afganët,” tha Presidenti Ashraf Ghani gjatë një fjalimi para të diplomuarve. “Sot, të gjithë afganët janë krenarë për institucionet e tyre të sigurisë dhe mbrojtjes. Ju jeni rojet e republikës. Forcat tona të sigurisë dhe mbrojtjes ishin të parët që iu përgjigjen përmbajtjeve të fundit. Ushtria po shndërrohet me forcë dhe shpejtësi të plotë në një ushtri të përkushtuar kombëtare, duke përfaqësuar politikën e madhe kombëtare, unitetin kombëtar dhe kompetencën profesionale”.

Qeveria Afgane do të marrë përgjegjësinë e plotë për akademinë në fillim të vitit 2021. “Akademia ka bërë një rrugë të gjatë dhe ka provuar më shumë se e aftë për të marrë pronësinë, mentorët gjatë viteve kanë bërë një punë më mbresëlënëse, dhe tani Akademia është e gatshme për të përcaktuar të ardhmen e saj”, tha shefi i Shtabit të Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, gjeneral Sir Nick Carter në një fjalim me shkrim për të diplomuarit. Së bashku me Australinë, Danimarkën dhe Zelandën e Re, Mbretëria e Bashkuar

ka luajtur një rol kryesor në ngritjen dhe zhvillimin e akademisë, përmes një programi trajnimit 48-javor bazuar në formatin e përdorur në Akademinë Mbretërore Ushtrake prestigjioze Sandhurst.

Akademia është “një pjesë e rëndësishme e misionit më të gjerë të Rezolutës Mbështetëse, këshillojë, asistojë misionin”, tha gjenerallejtnant Giles Hill (Mbretëria e Bashkuar), zëvendës komandant i Mbështetjes së Vendosur. “Ajo simbolizon partneritetin e fortë midis Rezolutës Mbështetëse dhe forcave afgane të sigurisë, dhe në veçanti, marrëdhëniet MB-Afganistan. Çdo ushtri ka nevojë për udhëheqës të rinj të trajnuar mirë dhe ata që me kohë, do të formojnë udhëheqjen e lartë të ushtrisë. E gjitha kjo fillon me bazat e lidershit të mësuara këtu”. Mbretëria e Bashkuar synon të mbajë një marrëdhënie institucionale afatgjatë me Akademinë, duke u ofruar të diplomuarve mundësi për të koordinuar me Sandhurst dhe për t’u lidhur me alumnit. Aleatët dhe partnerët e NATO-s qëndrojnë të vendosur për sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë të Afganistanit, duke vazhduar të ofrojnë mbështetje dhe këshilla për forcat afgane të sigurisë, përmes trajnimit dhe financimit.



USHTRIA KOMBËTARE AFGANE

NATO dhe Iraku punojnë ngushtë në luftën kundër terrorizmit

Më 16 shtator 2020, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u takua me ministrin e Jashtëm të Irakut Z. Fuad Mohammad Hussein, në Selinë e NATO-s në Bruksel. Sekretari i Përgjithshëm ndau simpatitë e tij me të thella për ata që preken nga pandemia COVID-19 dhe riafirmoi angazhimin e Aleatëve të NATO-s për të vazhduar mbështetjen e Irakut për t’iu përgjigjur kësaj krize. Z. Stoltenberg përshëndeti gjithashtu përpjekjet e vazhdueshme të Kryeministrit al-Kadhimi për të ndjekur një proces gjithëpërfshirës të reformave për ta bërë Irakun më të sigurt për njerëzit e tij dhe rajonin.

Z. Stoltenberg theksoi se NATO dhe Iraku po vazhdojnë të punojnë ngushtë së bashku në luftën kundër terrorizmit. Ai vlerësoi forcat irakiane të sigurisë për sakrificat e tyre në luftën kundër ISIS/Da’esh që i bënë Irakun dhe Aleatët e NATO-s më të sigurt. Ai nënvizoi se NATO mbetet e përkushtuar për të ndihmuar Irakun të forcojë forcat e tij të sigurisë. NATO tani po shqyrton mënyrën e rritjes së përpjekjeve të aleancës në Irak, në koordinim të plotë me qeverinë Irakene.

Me kërkesë të qeverisë Irakiane, NATO në tetor 2018 ra dakord për të krijuar Misionin tonë të NATO-s Irak (NMI) si një trajnim joluftarak dhe mision i ndërtimit të kapaciteteve, i kryer me respekt të plotë të sovranitetit dhe integritetit territorial të Irakut. Në shkurt 2020, ministrat e Mbrojtjes së NATO-s ranë dakord në parim për të rritur misionin e NATO-s në Irak.

ZËVENDËS SEKRETARI I PËRGJITHSHËM, MIRCEA GEOANĂ

NATO mbështet neutralitetin e Moldavisë

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoană priti në një takim ministrin e Punëve të Jashtme dhe Integritimit Evropian të Republikës së Moldavisë Oleg Țulea të enjten (10 shtator) për bisedime në lidhje me partneritetin NATO-Moldavi.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm tha se Republika e Moldavisë është një partner i rëndësishëm për NATO-n. Ai tha se NATO po ndihmon Republikën e Moldavisë të ndërtojë institucione të forta dhe qeverisje të mirë dhe theksoi se mbështetja e NATO-s për Moldavinë bazohet në kërkesën e Moldavisë.

Z. Geoană tha se NATO ka përvojë të konsiderueshme në reformat e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë dhe se Moldavia mund të mbështetet në këtë ekspertizë në mënyrë që të modernizojë institucionet e saj të sigurisë dhe forcat e armatosura. Ai vuri në dukje se NATO dhe Republika e Moldavisë tani po diskutojnë

një Plan të ri të Veprimit të Partneritetit Individual (IPAP) për dy vitet e ardhshme.

Duke iu drejtuar bashkëpunimit praktik, Z. Geoană tha se aleatët dhe partnerët e NATO-s i kanë dhënë mbështetje të vazhdueshme Republikës së Moldavisë në përgjigje të pandemisë COVID 19, duke përfshirë tone furnizime mjekësore dhe pajisje mbrojtëse. Ai theksoi se aleatët janë të përkushtuar të vazhdojnë të mbështesin Moldavinë për t'u marrë me këtë krizë, duke iu përgjigjur kërkesës së Moldavisë për ndihmë në Qendrën e Koordinimit Euro Atlantik të Reagimit të Fatkeqësive të NATO-s.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm përsëriti mbështetjen e NATO-s për neutralitetin kushtetues të Republikës së Moldavisë. Bashkëpunimi i NATO-s me Republikën e Moldavisë është me respekt të plotë për integritetin territorial dhe sovranitetin e vendit.



Kryetari Ushtarak i NATO-s, marshall Sir Stuart Peach

Turqia është një aleate e vlefshme e NATO-s

NATO po punon për të forcuar më tej mbrojtjen kolektive dhe për të projektuar stabilitetin përtej kufijve tanë dhe se Turqia po luan një rol kryesor në të dy aspektet



ari vuri në dukje se Turqia është aleati më i prekur nga trazirat dhe dhuna në Siri. Asnjë aleat tjetër nuk ka vuajtur më shumë nga sulmet terroriste. Ai njohti barrën që Turqia po mbart megjithatë, ai theksoi se Turqia

gjithashtu duhet të luajë rolin e saj në gjetjen e një zgjidhjeje afatgjatë të kësaj krize. Shefi i Ajrit, Marshal Peach theksoi se NATO do të vazhdojë të mbështesë Turqinë me një sërë masash të ndryshme; përfshirë

sistemet raketore mbrojtëse të cilat ndihmojnë për të mbrojtur Turqinë kundër kërcënimeve nga Siria si dhe përmes pranisë ajrore dhe detare. Shefi i Ajrit Marshal Peach vizitoi dy Qendrat e Ekselencës. Qendra e Ekselencës,

Mbrojtja kundër Terrorizmit dhe Qendra e Ekselencës, Komanda e Mbrojtjes kundër Terrorizmit dhe Trajnimi i Partneritetit për Paqe (PfP). Ai mori njoftime mbi projektet dhe punën e fundit të Qendrave.

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s viziton Komandën Tokësore Aleate

Shefi i Ajrit Marshall Sir Stuart Peach, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s vizitoi Komandën Aleate Tokësore të NATO-s në Izmir, Turqi në 9 shtator 2020. Ai u takua me Komandantin e Forcave Tokësore, (LANDCOM) gjeneral Lejtnant Roger L. Cloutier Jr i cili mori detyrën në gusht të këtij viti. Ndërsa ishte në Komandë, Shefi i Ajrit Marshal Peach mori informime mbi përgjegjësitë e misionit të LANDCOM dhe situatën e sigurisë në vendet fqinje. Duke folur me gjenerallejtënant Cloutier Jr, Kryetari diskutoi mbi konceptin e Mbrojtjes dhe Parandalimin e Zonës Euro-Atlantike, se si LANDCOM mundëson gatishmërinë, ndërveprimin, standardizimin dhe kompetencat e forcave tokësore të NATO-s dhe Partnerit, si dhe sfidat nga krahu jugor i NATO-s. Komandanti LANDCOM gjithashtu shfrytëzoi rastin për të informuar Kryetarin e qasjes së re të LANDCOM për Vlerësimet e Gatishmërisë



së Luftimit (CREVAL), të cilën ajo ndërmerr, nën kujdesin e Operacionit të Komandës Aleate të NATO-s. Kryetari përgëzoi Komandantin LANDCOM për punën që bën komanda në emër të Aleancës, të gjitha

trajnimet, konferencat, çertifikatat CREVAL dhe ushtrimet. Shefi i Ajrit Marshall theksoi se si NATO po shikon vazhdimisht se si mund të përmirësojë më tej gatishmërinë e forcave të saj, për t'i lëvizur ato me shpejtësi dhe për t'i mbështetur ato dhe sa i inkurajuar po ndiqte njoftimet e tij dhe vizitën në LANDCOM.

Shefi i Marshallit Ajror Sir Stuart Peach deklaroi se "Aleanca po luan një rol kryesor në përgjigjen ndaj sfidave nga jugu, përfshirë përmes misionit tonë në Afganistan, misionit tonë trajnuar në Irak dhe fluturimeve tona të mbikëqyrjes AWACS për Kolicionin Global për të Mposhtur ISIS. Duke punuar me partnerët tanë, qëllimi ynë është të ndihmojmë në menaxhimin e krizave në rajon. Të ndërtojmë qëndrueshmërinë e partnerëve tanë, në mënyrë që të mund të ndihmojmë në parandalimin e krizave dhe të rrisim parandalimin dhe mbrojtjen tonë kur kemi të bëjmë me sfida nga fqinjësia jonë jugore".

Nga 7 deri më 8 shtator 2020, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Shefi i Ajrit, marshall Sir Stuart Peach, vizitoi Stambollin, si pjesë e vizitave të tij të rregullta në vendet anëtare të aleatëve. Vizita zyrtare dy-ditore përbëhej nga takime me ministrin e Mbrojtjes, Z. Hulusi Akar, ministrin e Punëve të Jashtme, Z. Mevlut Cavusoglu dhe me shefin e Shtabit të Përgjithshëm Turk, gjeneralin Yasar Guler. Ndërsa ishte në Ankara, Kryetari i Komitetit ushtarak të NATO-s, vizitoi Qendrën e Ekselencës së NATO-s, Mbrojtja kundër Terrorizmit, si dhe Qendrën e Ekselencës, Komanda e Mbrojtjes kundër Terrorizmit dhe Trajnimi i Partneritetit për Paqe (PfP). Temat e diskutimit gjatë vizitës u përqëndruan në kontributet e Turqisë në operacionet, misionet dhe aktivitetet e NATO-s, situatën e sigurisë rajonale dhe NATO 2030. Në takimet e tij me ministrin e Mbrojtjes, Z. Hulusi Akar dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm Turk, gjeneralin Yasar Guler, Kryetari ushtarak i NATO-s, falënderoi Turqinë për kontributet e saj të vazhdueshme në operacionet, misionet dhe aktivitetet e NATO-s. Ai përgëzoi Turqinë për mbështetjen e saj me pajisje mjekësore për aleatët dhe partnerët e tjerë gjatë pandemisë së Koronavirusit.

Shefi i Ajrit, Marshall Sir Stuart Peach deklaroi se "Turqia jep kontribute thelbësore në operacionet dhe aktivitetet e NATO-s. NATO po punon për të forcuar më tej parandalimin dhe mbrojtjen tonë kolektive dhe për të projektuar stabilitetin përtej kufijve tanë dhe se Turqia po luan një rol kryesor në të dy aspektet".

Gjatë takimit të tij ministrin e Punëve të Jashtme, Z. Mevlut Cavusoglu, diskutimet u përqëndruan në kontributet e rëndësishme dhe të vlefshme të Turqisë në sigurinë e përbashkët të Aleancës dhe NATO 2030. Ata shkëmbyen mendime se si të përshtaten dhe të sigurojnë që Aleanca të mbetet e përshtatshme për t'u përballur me sfidat e dekadës tjetër. Kryetari theksoi se kjo "Ka të bëjë me mbajtjen e NATO-s të fortë ushtarakisht, duke e bërë atë më të fortë politikisht dhe më globale."

Lidhur me situatën në Siri, Kryet-



Ministri Quni uroi ambasadorin Rohde për detyrën e re dhe mirënjohjen e thellë për mbështetjen e përhershme të Gjermanisë ndaj Kosovës. Ai theksoi, se edhe donacioni që pranojmë sot është në vazhden e ndihmës së madhe të Gjermanisë, ministrisë së saj të mbrojtjes dhe forcave gjermane për ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin në stadin aktual të ministrisë dhe forcave tona.



Në kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë

Gjermania jep donacione të rëndësishme për FSK-në

Ky donacion do rrisë gadishmerinë e Shërbimit Mjekësor të FSK-së për të arritur të ashtuquajturin, kapacitet të “Rolit 1” të NATO-s

Në kazermën “Adem Jashari” të FSK-së në Prishtinë, u mbajtë ceremonia e pranimit të donacionit në pajisje mjekësore nga Republika e Gjermanisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Anton Quni, paraprkishti priti në zyrën e tij, ambasadorin e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, Joern Rohde. Në fillim ministri Quni e uroi ambasadorin Rohde për detyrën e re dhe mirënjohjen e thellë për mbështetjen e përhershme të Gjermanisë ndaj Kosovës. Ai theksoi, se edhe donacioni që pranojmë sot është në vazhden e ndihmës së madhe të Gjermanisë, ministrisë së saj të mbrojtjes dhe forcave gjermane për ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin në stadin aktual të ministrisë dhe forcave tona.

Ministri Quni vlerësoi lart edhe angazhimin e oficerëve dhe nënoficerëve gjerman në kuadër të ekipit të NALT nën lidhshimin e gjeneralit Best i cili vazhdon traditën e paraardhësve tjerë me profesionalizëm dhe efektivitet të lartë. “Gjermania si vend mik yni, është njëri ndër partnerët tanë kryesor strategjik dhe se sukseset tona të deritashme, bashkë me partnerët tjerë, janë të arritura të përbashkëta”. Nga ana e tij, ambasadori Rohde, ritheksoi zotimin e Gjermanisë për vazhdimin e mbështetjes së FSK-së për të arritur objektivat e saj zhvillimore dhe shprehu konfirmimin për intensifikimin dhe thellimin e mëtejme të



bashkëpunimit bilateral. Gjatë takimit ministri Quni shoqërohej nga komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rahman Rama dhe drejtori i Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha. Pas takimit, ministri Quni dhe ambasadori Rohde, morën pjesë në ceremoninë e

pranimit të donacionit me vlerë prej 500 mijë dollare në Regjimentin e Mjekësisë, respektivisht Qendrën Mjekësore të FSK-së.

Nga ana e tij, gjeneral Rama e falënderoi ambasadorin Rohde dhe stafin ushtarak gjerman për angazhimin e tyre të madh për këtë donacion dhe të gjitha donacionet dhe kontributet e

tyre të deritashme për ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së.

Ambasadori Rohde gjatë ceremonisë para të pranishmëve tha: “Është kënaqësi e veçantë që sot, gjatë vizitës time të parë në Ministrinë e Mbrojtjes, në emër të Qeverisë Gjermane, kam rastin të dorëzoj një donacion të madh me pajisje mjekë-

sore. Ky donacion do t'i mundësojë Shërbimit Mjekësor të FSK-së për të ngritur gatishmerinë e FSK-së në mënyrë që ajo të arrijë të ashtuquajturin, kapacitet të „Rolit 1“ të NATO-s. Realizimi i këtij donacioni ka qenë një bashkëpunim gjermano-kosovar në mes të këshilltarëve gjermanë dhe ekspertëve mjekësorë të FSK-së.“

Në fund, ministri Quni shprehu rëndësinë që kanë këto pajisje për aftësimin e personelit tonë për të qenë të gatshëm gjithmonë për reagim dhe trajtim të ndërsjellë në operacione dhe shpëtim të jetërave të qytetarëve. “Për çdo jetë të shpëtuar do të jemi krenarë së bashku” theksoi në fund, ministri Quni. Të pranishëm në ceremoni ishin edhe zyrtarë dhe oficerë nga ambasada dhe forcat gjermane si dhe ata nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Donacioni i sotëm është në vazhden e mbështetjes permanente të qeverisë dhe forcave gjermane në kompletimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të Regjimentit të Mjekësisë së FSK-së dhe shërbimit mjekësor të saj në të gjitha nivelet.

Kapaciteti ushtarak i Izraelit, i nevojshëm për zhvillimin e FSK-së

Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, i shoqëruar nga komandanti i FSK-së gjeneralletjënant Rahman Rama, priti në vizitë delegacionin e Kryerabinatit të Shqipërisë dhe Kosovës, kryesuar nga kryerabini Yoel Kaplan. Me këtë rast, ministri Quni shprehu falënderimin dhe vlerësimin e lart për vizitën e parë të kryerabinatit në ministrinë e mbrojtjes, pas deklarimit zyrtar të njohjes së Republikës së Kosovës nga ana e Izraelit. Ministri Quni, theksoi se populli i Kosovës, ndër vlerat më unike të saj ka respektin tradicional ndaj të gjitha besimeve dhe se diversitetin fetar e kultivon ndër breza si pasuri të saj të paprekshme. Ky realitet është dëshmuar gjatë gjithë historisë, e konkretisht edhe gjatë luftës së dytë botërore kur paraardhësit tanë strejuan dhe vunë nën mbrojtje me “besën shq-

iptare” hebrejntë nga fushata shfarosëse naziste. “Historia e popullit hebre për ne është e njohur sepse ka shumë të përbashkëta me të kaluarën e dhimbshme, por të lavdishme të popullit tonë” tha ministri Quni.


Nga ana e tij, kryerabini Kaplan, shprehu falënderimin për pritjen miqësore dhe vlerësoi lart vendimin e kryeministrit izraelit për njohjen e shtetit të Kosovës, duke besuar se vonesën e deritashme ta kompensojmë me zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të thellë në të gjitha fushat. “Gjithmonë kam pasur besim në të ardhmen tuaj të ndritur duke pasur parasysh rininë tuaj inteligjente. Do të jemi me ju në rrugëtimin tuaj për të ardhmen” theksoi z. Kaplan.

Duke shprehur mirënjohjen e thellë për kontributin e deritashëm të shtetit të Izraelit dhe popullit të tij për

mbështetjen e deritashme për Kosovën të kurorëzuar edhe me njohjen zyrtare, ministri Quni dhe gjeneral Rama, shprehën interesimin për zhvillimin e bashkëpunimit bilateral në fushën e mbrojtjes në nivel të ministrive dhe forcave respektive. Ata vlerësuan lart aftësitë dhe kapacitetet ushtarake të Izraelit si dhe eksperiencën e tyre në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes të nevojshme në stadin aktual të zhvillimit të FSK-së. Me këtë u pajtuan plotësisht të dy palët, duke besuar se kjo do të ndodhë së shpejti me zrytarizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore mes dy shteteve. Kryerabini Kaplan, gjatë vizitës shoqërohej edhe nga rabini i Tiranës, Yisroel Ivan Finman, sekretari i Kryerabinatit të Shqipërisë Geront Selenica dhe kryetari i Bashkësisë Hebreje “Bet Israel Kosova”, Ruzhdi Shkodra.

Mbështetje për lidhjen e invalidëve dhe viktimave civile të luftës

Me ftesë të ministrit të Mbrojtjes, Anton Quni, në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe kazermës së FSK-së “Adem Jashari” në Prishtinë ishin për vizitë një grup i grave të Lidhjes së Invalidëve dhe Viktimave Civile të Luftës kryesuar nga koordinatori, Mustafë Prenku. Grupi i grave vizitore kryesisht ishin nga punëtorja e shoqatës përkatëse me seli në Fushë Kosovë, e cila merret me rrobaqepësi dhe bizhuteri me punë dore. Duke u shprehur mirëseardhje, ministri Quni i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rahman Rama, shprehu respektin dhe konsideratën më të lartë si një ndër shembujt më të mirë të organizimit si shoqatë dhe angazhimin e tyre që me punë dore të mbajnë veten dhe familjet e tyre. “Ju me shembullin tuaj jeni bërë zëri i ndërgjegjes sonë institucionale dhe qytetare, andaj për këtë meritoni nderimin dhe respektin më të lartë” tha ai. Nga ana e tij, gjeneral Rama, shprehu gatishmerinë e plotë për përkrahje ndaj shoqatës, me të gjitha kapacitetet e FSK-së në dispozicion. “Ashtu siç kemi detyrim ligjor për të gjithë qytetarët e vendit, për ju dhe kategoritë tjera të dala nga lufta, kemi edhe detyrim moral për të qenë pranë jush me të gjitha mundësitë tona”. Pas takimit, grupi vizitorë u shoqërua nga ministri Quni dhe stafi i tij, në drekën e përgatitur në kazermën “Adem Jashari” duke përfunduar me prezantimin për historikun, strukturën, misionin dhe perspektivën zhvillimore të FSK-së. Përfaqësuesi i shoqatës dhe gratë vizitore shprehën emocionet dhe përshtypjet më të larta, falënderimin për ftesën dhe vizitën e realizuar duke pohuar se kjo është ftesa e parë që atyre u është bërë nga një institucion publik dhe udhëheqja e tij.



“Ky është një shembull i vërtetë se aleanca jep rezultate. Ne jemi mirënjohës Mbretërisë së Bashkuar për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Armatës sonë në proceset më të rëndësishme të zhvillimit, siç është transformimi i saj,” tha ministrja Shekerinska. Ambasadorja Galloway tha se Mbretëria e Bashkuar është e gatshme të vazhdojë dhe thellojë bashkëpunimin tashmë të vendosur në mbrojtje, i cili jep rezultate të shkëlqyera në transformimin e Armatës.



Ministrja Shekerinska- ambasadorja Britanike Rachel Galloway

Britania mbështet transformimin e ushtrisë maqedonase

Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë së Bashkuar në fushën e mbrojtjes

Gjeneral brigade John Bauron i Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar do të zëvendësojë gjeneral-brigade Hugh Lloyd Jones si Këshilltar i Armatës në procesin e saj të transformimit sipas standardeve të Aleancës. Për këtë qëllim, më 10 shtator 2020 në Ministrinë e Mbrojtjes, ministrja Radmilla Shekerinska dhe ambasadorja Britanike Rachel Galloway nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë së Bashkuar.

“Ky është një shembull i vërtetë se aleanca jep rezultate. Ne jemi mirënjohës Mbretërisë së Bashkuar për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Armatës sonë në proceset më të rëndësishme të zhvillimit, siç është transformimi i saj,” tha ministrja

Shekerinska.

Ambasadorja Galloway tha se Mbretëria e Bashkuar është e gatshme të vazhdojë dhe thellojë bashkëpunimin tashmë të vendosur në mbrojtje, i cili jep rezultate të shkëlqyera në transformimin e Armatës.

Gjenerali Bauron ka përvojë të gjërë në Forcat e Armatosura Bri-

tanike, ka shërbyer në operacione dhe misione në Bosnjë-Hercegovinë dhe Irak dhe ka qenë pjesë e Forcave të Sigurisë së Zhvillimit të Pakistanit, në Bregun Perëndimor dhe në Jeruzalem. Pozicioni i tij i fundit është në Akademinë e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, ku ai gjithashtu udhëhoqi transformimin e Akademisë.

RADMILLA SHEKERINSKA:

“Ne jemi NATO” për nder të 8 shtatorit, Ditën e Pavarësisë

Në shpatet e Bistrës, ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska Nudhëhoqi turin tradicional malor për nder të festës më të madhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut-8 Shtatorin, Ditën e Pavarësisë. Ngjitja e malit Bistra këtë vit është nën moton “Ne jemi NATO”, veçanërisht duke marrë parasysh që festojmë Ditën e Pavarësisë për herë të parë si një anëtare e plotë e Aleancës së NATO-s, një nga dy qëllimet strategjike të pavarësisë së vendit tonë.

„Edhe këtë vit kemi dashur të tregojmë në këtë mënyrë simbolike se qëllimet tona strategjike janë si ngjitja në një nga majat e maleve. Ju duhet një plan, ju duhet organizim, ju duhet forcë, ju duhet durim, por kënaqësia



është me të vërtetë e madhe. Ne e bëmë këtë vitin e kaluar përballë ambicies sonë për t’u bërë një anëtare e NATO-s. “Këtë vit jemi duke u ngjitur për herë të parë si një anëtar i NATO-s, nuk ishte e lehtë, ishte edhe më e vështirë sepse ambiciet tona u bënë edhe më të mëdha,” tha ministrja Shekerinska. Ministrja theksoi se arritëm ta realizonim këtë synim tonë 30-vjeçar, por nuk ndalemi këtu. “Ne duam të sigurojmë një Armatë më të mirë, dhe një Armatë më efikase, të paguar më mirë dhe të pajisur më mirë e cila ekziston për qytetarët, një Armatë që si pjesë e Aleancës më të fuqishme ushtarako-politike do të jetë në gjendje të garantojë sigurinë, dhe meqenëse garanton sigurinë do të jetë në gjendje të garantojë zhvillim”, shtoi Shekerinska. Ambasadorja e SHBA, Kate Burns tha se këtë vit vendi ynë feston Ditën e Pavarësisë, për herë të parë si anëtare e Aleancës, dhe SHBA dhe Republika e Maqedonisë së Veriut qëndrojnë së bashku në një komunitet. “Shtetet e Bashkuara mbeten një partner i fortë i Republikës së Maqedonisë së Veriut,” theksoi Burns.

Ditën e Pavarësisë na uroi gjithashtu Ambasadorja e Mbretërisë së Bashkuar, Rachel Galloway, si dhe Shefi i Zyrës Ndërlidhëse të NATO-s, kolonel Zoran Jankoviq. Turneu malor realizohet në bashkëpunim me Shoqatën e Guidave Ndërkombëtare dhe Shoqatën për mbrojtjen dhe shpëtimin e maleve dhe terreneve të paarrishme “Asklepjij”.

Në turneun malor morën pjesë përfaqësues të trupit diplomatik, atashet e mbrojtjes, përfaqësues të Komandës së Brigadës së Evropës Juglindore, e cila kohët e fundit është vendosur në Kumanovë, përfaqësues të Zyrës Ndërlidhëse të NATO-s, Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes me Shtetet e Bashkuara, Qeverisë, Forcat Speciale Mjekësore Ballkanike, punonjësit e Ministrisë dhe oficerë dhe ushtarë të Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Gjeneral Gjurginovski priti Komandantin e KFOR-it Gjeneral Risi


Një delegacion nga Komanda e Misionit të KFOR-it e udhëhequr nga Komandanti i Misionit, Gjeneral Major Michele Risi, bëri një vizitë pune në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

Pasi u mirëprit nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Lejtnant Vasko Gjurginovski, gjatë takimit të punës në Shtabin e Përgjithshëm delegacioni i KFOR u njoh me procesin në vazhdim të transformimit dhe modernizimit të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore, pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse. Gjeneralët Gjurginovski dhe Risi diskutuan tema që vijnë nga bashkëpunimi i ndërsjellë, të tilla si kontributi maqedonas në mision, situata e sigurisë në fushën e përgjegjësisë së misionit, aktivitetet e



mëtejshme të përbashkëta dhe shkëmbimi i informacionit. Gjatë vizitës në Ministrinë e Mbrojtjes, Gjenerali Risi gjithashtu u takua me Ministrën e Mbrojtjes Radmilla Sekerinska. Pjesëmarrja e Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore në misionin e NATO-s, KFOR

indirekt daton që nga viti 2007 kur filloi qendra koordinuese për mbështetjen e vendit pritës, detyra kryesore e të cilit është të koordinojë me forcat e KFOR-it në doganat dhe procedurat e transportit kufitar, duke përfshirë dhe nevojat e tjera logjistike të KFOR-it.



“Si Ministër i Mbrojtjes do të bëj gjithçka që është në fuqinë time për të ruajtur buxhetin e mbrojtjes deri në shifrat e vitit 2020 për të ruajtur gjendjen ekzistuese të të drejtave materiale dhe për të investuar përpjekje shtesë në realizimin e projekteve të modernizimit dhe pajisjeve për Forcat e Armatosura Kroate”.



MINISTRI KROAT I MBROJTJES MARIO BANOSHIÇ

Përfundon projekti për ndërtimin e anijeve patrulluese në bregdet

Marina Kroate do të marrë anije patrullimi të klasit të lartë me një çmim të volitshëm dhe brenda një periudhe të shkurtër

Ministri Kroat i Mbrojtjes Mario Banoshiç dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Kroate Admirali Robert Hranj në 2 Shtator vizituan Marinën Kroate dhe Kompaninë “Brodosplit” në Split. Ministri dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm vizituan dhomën përkujtimore të pjesëtarëve të rënë të marinës kroate në kazermet e marinës “Sveto Letica-Barba” dhe morën pjesë në një prezantim të mbajtur nga komandanti i marinës kroate, admiral Ivo Raffanelli, më arritjet dhe sfidat përpara Marinës Kroate.

Ministri Banoshiç gjithashtu pa anijen patrulluese të bregdetit të Marinës Kroate OOB-31 “Omiš” dhe mori pjesë në një ceremoni të vendosjes së anijeve të reja të Marinës Kroate në Brodosplit. Ministri Banoshiç vlerësoi vizitën në Marinën Kroate dhe aktivitetet e paraqitura. Megjithatë situata e pandemise do të ndikojë në mënyrë të pashmangshme në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes në 2021, Ministri Banoshiç theksoi: “Si Ministër i Mbrojtjes unë do të bëj gjithçka që është në fuqinë time për të ruajtur buxhetin e mbrojtjes deri në shifrat e vitit 2020 për të ruajtur gjendjen ekzistuese të të drejtave materiale dhe për të investuar përpjekje shtesë në realizimin e projekteve të modernizimit dhe pajisjeve për Forcat e Armatosura Kroate”. Ministri veçoi përfundimin e projektit të ndërtimit të anijeve patrulluese në bregdet, dhe prokurimin e motorëve dhe rregullimin e anijeve me raketa.

“Detyra jonë e pashmangshme është të zhvillojmë dhe miratojmë Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura Kroate për periudhën 2022



- 2033, në të cilin do të përshkruajmë parashikimet për zhvillimin e Marinës Kroate dhe Forcave të Armatosura Kroate, duke pasur parasysh gjithashtu detyrimet e përfshira në qëllimet e miratuara të aftësive të NATO-s”. Ministri theksoi rëndësinë e zhvillimit të aftësive të Forcave të Armatosura

Kroate për misionin e tyre të ofrimit të ndihmës për komunitetin, kurdo që është e mundur. Duke theksuar rolin e rëndësishëm të Forcave të Armatosura Kroate në misionet dhe operacionet ndërkombëtare të mbështetjes së paqes, Ministri Banoshiç i uroi sukses ekipazhit të anijes e cila do të nisej për të

marrë pjesë në operacionin e NATO-s “Guardian Sea” dhe për të promovuar Marinën Kroate dhe Kroacinë në mënyra më e mirë e mundshme, siç bënë edhe paraardhësit e tyre.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm nënvizoi rëndësinë e investimeve të mëtejshme në Marinën Kroate, e cila

mbroton territorin detar gati të barabartë me madhësinë e Kroacisë kontinentale. “Kontributi më i dukshëm i Armatosur Kroate dhe në këto kushte të paqes është përmes detyrave për të ndihmuar institucionet civile dhe popullin tonë,” përfundoi Admirali Hranj. Gjatë ceremonisë në Brodosplit, CEO Tomislav Debeljak i shprehu mirënjohje Ministrin Banoshiç për mbështetjen e këtij projekti dhe ndërtimin e vazhdueshëm të anijeve patrulluese bregdetare. “Kjo është një situatë fitore për të dy palët - shteti dhe Marina Kroate do të marrin anije patrullimi të klasit të lartë me një çmim të volitshëm dhe brenda një periudhe të shkurtër. “Unë jam veçanërisht i lumtur që anijet do të ndërtohen në një kantiër detar kroat dhe që Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura Kroate kontribuojnë në rritjen e përgjithshme ekonomike të Kroacisë,” tha Ministri Banoshiç, duke deklaruar se Marina Detare Kroate duhet të jetë e fortë për të garantuar sigurinë e detit Adriatik.

SHBA-partner i rëndësishëm ushtarak i Kroacisë

Ministri Kroat i Mbrojtjes Mario Banoshiç u takua me Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara në Kroaci H. E. Robert Cohorst në 1 Shtator 2020, në një vizitë pritëse. Gjatë takimit Ministri dhe Ambasadori Kohorst pohuan marrëdhëniet e shkëlqyera bilaterale të mbrojtjes dhe bashkëpunimit produktiv brenda NATO-s. Ata diskutuan pjesëmarrjen e përbashkët në operacionet, misionet dhe aktivitetet e drejtuara nga NATO, si dhe projekte të pajisjeve, trajnime, edukime dhe stërvitje ushtarake të Forcave të Armatosura Kroate dhe të SH.B.A. Shtetet e Bashkuara janë një partner i rëndësishëm strategjik i Republikës së Kroacisë në fushën e mbrojtjes dhe Ministri Banoshiç deklaroi se bashkëpunimi i vazhdueshëm i suksesshëm do të ishte




një nga përparësitë gjatë zyrës së tij. Të dy palët përfunduan takimin duke vlerësuar bashkëpunimin e

deritanishëm dhe duke shprehur gatishmërinë dhe për bashkëpunimin e ardhshëm dhe komunikimin e biznesit.



Ministri Banoshiç takohet me Ambasadorin Francez

Ministri Kroat i Mbrojtjes Mario Banoshiç më 3 Shtator u takua me Ambasadorin Francez në Kroaci, H. E. Gael Veysiere, në një takim të parë pas emërimit të Ministrin Banoshiç me një ambasador Evropian. Ministri dhe Ambasadori shkëmbyen përvoja dhe mendime mbi presidencën e fundit kroate të Këshillit të Bashkimit Evropian, pandeminë-19, dhe pajisjet dhe projektet e modernizimit. Të dy palët vlerësuan mundësinë për takimin dhe bashkëpunimin e zgjeruar dypalësh të mbrojtjes. Ata gjithashtu pohuan marrëdhëniet e mira bilaterale dhe deklaruan qëllimin për t'i forcuar dhe intensifikuar më tej ato.



“Hirushja Thrakiane-2020” është trajnimi më i madh ndërkombëtar i fluturimit këtij viti me pjesëmarrjen e Forcës Ajrore Bullgare, e cila u sigurojë pjesëmarrësve mundësi për të gjeneruar përvojë të pasur në ndërveprim real në një mjedis ndërkombëtar.



“HIRUSHJA THRAKIANE-2020”

Stërvitje ndërkombëtare në hapësirën ajrore të Bullgarisë

Marrin pjesë avionë luftarakë nga Forcat Ajrore Bullgare, Amerikane, Rumune, Greke dhe Kanadeze

Nga data 14 deri më 25 shtator, Forcat Ajrore Bullgare po zhvillojnë në hapësirën ajrore të bullgarisë stërvitjen ndërkombëtar ajrore “Hirushja Thrakiane-2020”, ku marrin pjesë Forca Ajrore Mbretërore Kanadeze, si dhe nga Forcat Ajrore të Republikës Greke dhe Rumanisë. Stërvitjes në javën e dytë i janë bashkuar ekuipazhet nga Forca Ajrore Amerikane në Evropë me avionët F-16, të cilët u zhvendosën në Bazën Ajrore “Graf Ignatievo”.

Drejtuksi i stërvitjes së fluturimit në anën Bullgare është komandanti i Bazës Ajrore “Graf Ignatievo”, Gjeneral Brigade Dimitar Petrov. Sipas skenarit të operacioneve të trajnimit, Forca Ajrore Bullgare do të përmirësojë stërvitjen e saj në operacionet ajrore mbrojtëse dhe sulmuese së bashku me partnerët e saj të koalicionit. Njësitë e Forcave Ajrore dhe Forcave Tokësore do të mbrojnë territorin dhe vendet e infrastrukturës kritike bullgare nga veprimet e grupeve të aviacionit të përziera, të cilat do të simulojnë sulmet. Plani i trajnimit parashikon që kompleksiteti i detyrave të kryera të rritet me rrjedhën e veprimeve të trajnimit dhe të realizojnë zbatimin e detyrave specifike për aviacionin dhe mbrojtjen ajrore.

Nga pala bullgare, marrin pjesë avionë luftarakë MiG-29, njësitë stërvitore dhe luftarakë L-39 nga baza ajrore “Graf Ignatievo”, helikopterë Mi-24 dhe AS-532 Cougar nga baza ajrore “Krumovo”. Forca Ajrore Mbretërore Kanadeze operon me avionë luftarakë F-18. Avionet luftarakë nga Forcat Ajrore Rumane dhe Greke, F-16 dhe MiG-21 kryejnë fluturime ngritjeje dhe uljeje nga bazat e tyre për



vendosjen e përhershme.

“Hirushja Thrakiane-2020” është trajnimi më i madh ndërkombëtar i fluturimit këtij viti me pjesëmarrjen

e Forcës Ajrore Bullgare, e cila u sigurojë pjesëmarrësve mundësi për të gjeneruar përvojë të pasur në ndërveprim real në një mjedis ndërkombëtar.

Përmirësohet ndërveprimi midis Forcave Tokësore dhe Ajrore

Forcat Tokësore dhe Forcat Ajrore përmirësojnë ndërveprimin gjatë stërvitjeve të përbashkëta. Në mënyrë që të përmirësohet ndërveprimi midis formacioneve të Forcave Tokësore dhe Forcave Ajrore, stërvitja e përbashkët u realizua nga ushtarët e Brigades 61 të Mekanizuar dhe Baza e 24-të Ajrore-Krumovo. Batalionet e mekanizuara dhe batalioni ISTAR nga brigada 61 e mekanizuar dhe ekuipazhet dhe helikopterët nga baza ajrore Krumovo morën pjesë në to. Trajnimi i përgjithshëm u krye në terrenet e stërvitjes së Brigadës 61 të Mekanizuar. Ushtarët realizuan detyrat për të siguruar një vend uljeje për helikopterë, afrimin, ngarkimin dhe shkarkimin e personelit dhe burimeve materiale gjatë zhvendosjes nga një zonë në tjetrën. Trajnimet e përbashkëta do të vazhdojnë në të ardhmen, pasi aftësitë e fituara do të jenë të zbatueshme në kryerjen e operacioneve të përbashkëta.



Medalje për Kontingjentin e 40-të ushtarak në Afganistan

Ushtarëve nga Kontingjenti Ushtarak Kombëtar i 40-të Bullgar u dha medalje për pjesëmarrjen në Misionin e Mbështetjes së Vendosur të NATO-s. Në një ceremoni në Aeroportin Kandahar të Afganistanit, ushtarët nga Kontingjenti i 40-të Kombëtar Ushtarak u dhanë medalje për pjesëmarrjen në Misionin e Mbështetjes së Vendosur të NATO-s. Komandanti i Komandës së Jugut, Gjeneral Brigade Michael Eastman, falënderoi Komandën e Misionit të NATO-s, personelin e kontingjentit të 40-të Bullgar për kryerjen e shkëlqyeshme të detyrave të sigurisë në bazë. Ai shprehu besimin se ushtarët e kontingjentit të ardhshëm ushtarak Bullgar do të vazhdojnë të përfaqësojnë me



dinjtet Forcat e Armatosura Bullgare në misionin e NATO-s në Afganistan. Gjeneral Brigade Michael Eastman paraqiti medalje për pjesëmarrjen në “Mbështetje Vendimtare” elementit kombëtar, ekipit të këshilltarëve dhe

kompanisë së sigurisë.

Të ftuar zyrtarë të ceremonisë ishin koloneli James Murray - Zëvendëskomandanti i Komandës, Komandanti Kombëtar i Kontingjentit Ushtarak Rumun, Kryegjeneralët e Komandës Jugore dhe Kontingjentit Rumun, ushtarë nga kontingjentet e partnerëve të koalicionit me të cilët kontingjenti Bullgar bashkëvepron në kryerjen e detyrave. Kontingjenti i dyzetë ushtarak ka një total prej deri në 160 ushtarë me një strukturë të elementit kombëtar, një kompani sigurie, një ekip këshilltarësh dhe oficerë shtabi. Në misionin e NATO-s në Afganistan për 6 muaj, ushtarët bullgarë kryejnë detyra në lidhje me organizimin e regjimit të kontrollit të hyrjes në trafikun e makinave në aeroportin në Kandahar.



Zhvillohet stërvitja taktike “Garda Pirin-2020”

Ushtarët e Forcave Tokësore bullgare demonstruan bashkëpunim të mirë gjatë stërvitjes taktike “Garda Pirin-2020” “Për Komandën e Brigadës, ky ishte një ushtrim shumë i rëndësishëm për të cilin efektiviteti i cilet ishin përgatitur për gati një vit. Unë jam jashtëzakonisht i kënaqur me atë që ushtarët demonstruan këtu në terrenin e trajnimit “

Ja familjet më të fuqishme të historisë

Nga Rothschildët tek Medicit, nga Khanët tek Habsburgët

Familja Rothschild (shpesh herë thërriten thjeshtë Rothschildët) është një dinasti ndërkom-bëtare në sektorin bankar dhe të financave me origjinë hebrejsh nga Gjermania, që nisi veprimtarinë në të gjithë Evropën dhe mori titull fisnikërie nga qeveritë austriake dhe britanike. Ngjitja e famës së familjes në skenën ndërkombëtare nisi me Mayer Amschel Rothschild (1744-1812), strategjia e të cilit për suksesin në të ardhmen ishte të ruante kontrollin e bizneseve të tyre në duart e familjes, gjë që u lejonte atyre të ruanin sa më shumë sekretin në lidhje me pasurinë e tyre si dhe arrijtjet në fushën e biznesit. Mayer Rothschild arriti që me sukses të ruajë pasurinë brenda familjes, përmes martesave të menduara me kujdes brenda pjesëtarëve dhe të afërmeve të ngushtë të familjes.

Nathan Mayer Rothschild nisi biznesin e tij londinez, "N. M. Rothschild and Sons" në vitin 1811 në New Court, në qytetin e Londrës, biznes që vazhdon të ekzistojë në të njëjtin vend edhe sot e kësaj dite. Në vitin 1818, ai dha një hua prej 5 miliardë sterlinash për qeverinë prusiane dhe dhënia e bonove për huatë qeveritare u shndërrua në shtyllën kryesore të biznesit të tij në fushën e bankave. Ai arriti një pozicion kaq të fuqishëm në qytetin e Londrës, sa që deri në vitin 1825-1826 ishte tashmë në gjendje që t'i ofronte një sasi të mjaftueshme monedhash Bankës së Anglisë me qëllim që t'i mundësonte asaj shmangien e një krize likuiditetesh.

Plantagenetët

Në përfundimin e paqartë mes Plantagenetëve dhe Tudorëve, Plantagenetët fituan për arsye se pjesa më e madhe e zhvillimit të kulturës angleze si dhe të sistemit politik (që mbetet edhe sot e kësaj dite) e pati startin pikërisht në kohën esundimit të tyre. Në kohën e Tudorëve, u krijua Kisha Anglikane dhe disa thonë se në kohën e tyre ka patur edhe një epokë të artë, por rëndësia e linjës së Plantagenetëve është shumë më e madhe (dhe veç të tjerash, nuk duhet harruar se edhe Henri i VIII ishte një pasardhës direkt nga nëna i familjes së Plantagenetëve). Shtëpia e Plantagenetëve ishte një Shtëpi Mbretërore e themeluar nga Henry II i Anglisë, djali i Geoffrey V i Anjousë. Mbretërit Plantagenetë sunduan fillimisht Mbretërinë e Anglisë në shekullin 12. Në total, pesëmbëdhjetë monarkë Plantagenetë, duke përfshirë ata që u përkisnin degës së kadetëve sunduan Anglinë në periudhën mes viteve 1154 dhe 1485. Një kulturë dhe art i spikatur anglez lindi dhe u zhvillua gjatë erës së Plantagenetëve, inkurajuar edhe nga disa prej monarkëve të cilët ishin përkrahës të mëdhenj të "babait të poezisë angleze", Geoffrey Chaucer. Stili i arkitekturës gotike ishte shumë populullor gjatë asaj kohe, me ndërtesa të tilla si Westminster Abbey dhe York Minster që u rimodeluan pikërisht sipas atij stili. Pati gjithashtu edhe zhvillime me një rëndësi jetëgjatë në sektorin social, si përshtetja e Magna Carta nga ana e Johnit I të Anglisë. Kjo pati një ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimin e nluigjeve të zakonshëm dhe ligjeve kushtetues. Institucionet politike, si Parlamenti i Anglisë dhe Parlamenti Model e kanë origjinën pikërisht në periudhën e Plantagenetëve, ashtu si edhe shumë institucione arsimore, përfshirë Universitetet e Kembrixhit dhe Oksfordit.

Familja Nehru-Gandhi

Familja Nehru-Feroz Gandhi është një familje politike indiane që ka dominuar në Kongresin Kombëtar të

Indisë përgjatë pjesës më të madhe të periudhës së pavarësisë së hershme të Indisë. Tre pjesëtarë të kësaj familjeje (Pandit Jaëharlal Nehru, bija e tij Indira Gandhi dhe djali i saj, Rajiv Gandhi) kanë qenë Kryeministra të Indisë, dy prej të cilëve (Indira dhe Rajiv Gandhi janë vrasë). Një pjesëtarë e katërt e familjes, Sonia Gandhi është aktualisht Presidente e Kongresit, ndërkohë që ajo dhe djali i Rajivit, Rahul Gandhi janë pjesëtarë të rinj të familjes që hyjnë në politikën aktive, kur ai konkuroi dhe më pas fitoi një vend në dhomën e ulët të parlamentit të Indisë në vitin 2004. Familja Nehru-Feroz Gandhi nuk ka asnjë lidhje me udhëheqësin e pavarësisë së Indisë, Mohandas Gandhi. Nehru-Gandhët janë shembulli më i sipkatur i traditës së udhëheqjes dinastike në shtetet demokratike të Azisë.

Familja Khan

Ghengis Khan ishte themeluesi, Khan (sundues) dhe Khagan (perandor) i Perandorisë Mongole, perandoria më e madhe e solid enë historinë e njerëzimit. Ai erdhi në pushtet duke bashkuar shumë prej tribuve nomade të Azisë verilindore. Pasi themeloi perandorinë Mongole dhe u shpall "Ghengis Khan", ai filloi pushtimet mongole si dhe sulmet në zonat e Kara-Khitana, Kaukazit, Perandorinë Khwarezm, Ksian Perëndimore dhe dinastitë Jin. Gjatë jetës së tij, perandoria mongole pushtoi një pjesë shumë të madhe të Azisë Qendrore. Përpara se Ghengis Khan të vdiste, ai emëroi Ogedei Khanin si pasardhës të tij dhe e ndau perandorinë e tij në Khanates mes bijve dhe nipërve. Ghengis Khan vdiq në vitin 1227 pasi mposhti Tangutsët. Khan u varros në një varr pa shenjë diku në Mongolinë në një vend të panjohur. Pasardhësit e tij vazhduan ëprprkjet për të hstrirë perandorinë mongole deri në pjesën më të madhe të Eurazisë duke pushtuar ose krijuar shtete vasalë në zonat e Kinës së sotme, Koresë, kaukazit, shteteve të Azisë Qendrore si dhe një pjesë të madhe të zonave të asaj që sot është Evropa Lindore dhe të Lindjes së Mesme.

Familjet Claudia and Julius

Këto dy familje janë bashkuar në një duke qenë se kanë qenë familjet më të rëndësishme të Romës së Lashtë

dhe ato u bashkuan së bashku për të krijuar dinastinë Julio-Claudianë nga e cila kanë dalë edhe pjesa më e madhe e perandorëve më të famshëm të Romës: Kaligula, Augusti, Klaudiusi, Tiberiusi dhe Neroni. Këta pesë perandorë sunduan perandorinë romake në periudhën që nga viti 27 para Krishtit deri në vitin 68 pas Krishtit, atëherë kur i fundmi i kësaj linje, Neroni kreu vetëvrasje. Këta pesë sundimtarë u lidhën përmes martesave dhe adoptimeve. Julius Caesar sihiet ndonjëherë pasaktësisht si themeluesi i saj, ndonëse ai nuk ka qenë as perandor dhe as nuk kishte lidhje Claudiane; më gjerësisht pranohet që themeluesi i dinastisë ka qenë Augusti. Mbretërimet e perandorëve Julianë-Claudianë kanë disa tipare të përbashkët: të gjithë erdhën në pushtet përmes lidhjeve indirekte apo adoptimeve. Secili prej tyre zgjeroi territorin e perandorisë romake dhe inicioi projekte masive ndërtimi. Ata përgjithësisht duheshin nga njerëzit e zakonshëm, por kishin kundër armiqtësinë e klasës së senatorëve – një ndjenjë që pasqyrohet nga historianët e lashtë. Historianët e lashtë e përshkruajnë dinastinë Julio-Claudianë si vetëzmadhuese, të marrë, perverse dhe tiranike.

Familja Zhu

"Zhu" ishte emri i familjes për perandorët e dinastisë Ming. Perandori i parë Ming, Hongvu (Zhu Juanzhang) zgjodhi që të përdorë emrin Ming si emër të dinastisë. Ming do të thotë "Brilant". Dinastia Ming ishte dinastia sunduese e Kinës në periudhën mes viteve 1368 dhe 1644, në vijim të kolapsit të dinastisë Juan që udhëhiqej nga Mongolët. Epoka e Ming, "një prej epokave më madhështore të qeverisjes së rregullt dhe stabilitetit social në historinë e njerëzimit" ishte e fundmja dinasti në Kinë që drejtohej nga etnia Hans. Ndonëse kryeqyteti i perandorisë Ming, Pekini ra në vitin 1644 për shkak të një rebelimi të udhëhequr nga Li Zisheng, që nga ana e tij shumë shpejt u zëvendësua nga Dinastia Qing e udhëhequr nga Manchurianë (familja e fundit perandorake kineze), regjime besnikë ndaj fronit të Ming (të njohur kolektivisht si Mingët juygorë) mbi jetuan deri në vitin 1662. Gjatë kohës së sundimit të Ming u ndërtua një flotë shumë e madhe si dhe një ushtri prej një milionë trupash. Pati projekte shumë të

mëdha ndërtimi, duke përfshirë restaurimin e Kanalit të Madh dhe të Murit të Madh si dhe ngritjes së Qytetit të Ndalaruar në Pekin, gjatë çerekut të parë të shekullit të pesëmbëdhjetë. Vlerësimet për popullsinë e Ming variojnë nga 160 në 200 milionë banorë. Dinastia Ming konsiderohet shpesh si një prej pikave më të larta të qytetërimit kinez, si dhe një dinasti në të cilën janë shfaqur shenjat e para të kapitalizmit.

Habsburgët

Shtëpia e Habsburgëve ishte një shtëpi shumë e rëndësishme mbretërore në Evropë dhe ajo njihet më së miri si furnizuesja me Perandorët e Shenjtë Romakë të zgjedhur formalisht në periudhën mes viteve 1452 dhe 1740, si dhe sunduesit e Spanjës dhe të Perandorisë Austriake. Me origjinë nga Zvuicra, dinastia mbretërore fillimisht në Austri, të cilën e sunduan për më shumë se gjashtë shekuj, por një seri martesash dinastike sollën Burgundin, Spanjën, Boheminë, Hungarinë dhe territore të tjera në trashëgiminë e saj. Dinastia e ka marrë emrin nga vendi i origjinës, Kështjella Habsburg që ndodhet në Kantonin zviceran të Aargaut. Motoja e dinastisë është: "Le të bëjnë luftë të tjerët, por ti, Austri e lumtur, do të martohesh", që është edhe një tregues i talentit të Habsburgëve për të lidhur pjesëtarët e vet në martesë me shtëpi të tjera mbretërore të Evropës, me qëllimin për të bërë aleanca dhe trashëguar territore. Perandoresha Maria Tereza njihet mbi të gjithë në këtë drejtim dhe ndonjëherë ajo quhet edhe si "Në-nëgjyshja e Evropës".

Familja Ptolemaike

Dinastia Ptolemaike ishte një familje mbretërore nga zona e Maqedonisë në Greqi që sundoi Perandorinë Ptolemaike në Egjipt për afro 300 vjet, nga viti 305 para Krishtit deri në vitin 30 para Krishtit. Ptolemi, njëri prej shtatë truprojave që shërbyen si gjeneralë dhe zëvendës të Aleksandrit në vitin 323 para Krishtit. Në vitin 305 para Krishtit, ai u vetëshpall Mbreti Ptolemi I, më vonë i njohur si "Soter" (shpëtimtar). Shumë shpejt, egjiptianët pranuan familjen Ptolemaike si pasardhës të faraonëve të Egjiptit të pavarur.

Familje ptolemaike e sundoi Egjiptin deri kur ndodhi pushtimi romak në vitin 30 para Krishtit. Pjesëtarja më e famshme e kësaj linje ishte mbretëresha e fundit, Kleopatra VII, e njohur më së miri për rolin e saj gjatë betejave politike romake ndërmjet Jul Cezarit dhe Pompeit, dhe më vonë ndërmjet Oktavianit dhe mark Antonit. Vetëvrasja e saj pas pushtimit prej romës shënoi edhe fundin e sundimit ptolemaik në Egjipt.

Familja Medici

Familja Medici ishte një familje e fuqishme dhe me shumë influencë në Firencë në periudhën nga shekulli 13 deri në shekullin 17. Nga kjo familje dolën tre Papë (Leo X, Klement VII dhe Leo XI), shumë sundimtarë të Firences (më i spikatur ishte Lorenzo i Mrekullueshmi, një prej përkrahësve dhe sponsorizuesve të disa prej veprave më të famshme të artit të Rilindjes) si dhe më vonë pjesëtarë të shumë prej familjeve mbretërore angleze dhe franceze. Ashtu si shumë familje të tjera zotërinsh, mata dominuan qeverisjen e qytetit të tyre. Ishin në gjendje të vendosnin Firencën nën pushtetin e familjes së tyre, duke krijuar një ambient në të cilin lulëzuan arti dhe humanizmi. Ata u bënë udhëheqës të rrugës drejt Rilindjes së Italisë së bashku me shumë familje të tjera të mëdha zotërinsh në Itali, si familjet Visconti dhe Sforza në Milano, familjen Este në Ferrara dhe Familjen Gonzaga në Mantua. Banka Medici ishte një prej institucioneve financiare më të suksesshëm dhe më të respektuar në Evropë. Siaps disa përllogaritjeve, familja Medici ka qenë për një periudhë kohe familja më e pasur e Evropës. Duke u nisur nga kjo bazë, ata fituan pushtet politik fillimisht në Firencë dhe më pas më gjerësisht në Itali dhe në Evropë.

Familja Capetiane

Dinastia Capetiane është shtëpia mbretërore më e madhe e Evropës. Ajo përfshin cdonjërin prej pasardhësve direkt të Capetit të madh të Francës. Mbreti Huan Karlos i Spanjës dhe Duka i Madh Henri i Luksemburgut janë pjesëtarë të kësaj familje, të dy përmes degës Burbone të dinastisë. Gjatë shekujve të kaluar, Capetianët u përhapën nëpër Evropë duke sunduar kudo, që nga njësitë provinciale deri tek çifligje e mbretëri. Përveçse është familja më e madhe për nga numri në Evropë, ajo është familja ku ka edhe më shumë incese, sidomos në Monarkinë spanjolle. Kanë kaluar shumë kohë që kur monarkët Capetianë sunduan pjesën më të madhe të Evropës, megjithatë ata vazhdojnë të mbeten diku mbretërit e diku me tituj të tjerë. Aktualisht, dy monarkë Capetianë vazhdojnë të mbretërojnë në Spanjë dhe në Luksemburg. Veç këtyre, shtatë përfaqësues të kësaj kompanie përfaqësojnë dinasti monarkike në mërgim në Brazil, Francë, Spanjë, Portugali, Parma dhe Dy Siçilitë. Kryetari aktual legjitim i familjes është Louis Alfonso, Duka i Anjou-së i cili është gjithashtu pretendenti i ligjshëm i fronit të Francës. Në total, dhjetëra degë të dinastisë Capetiane vazhdojnë të ekzistojnë në të gjithë Evropën.

U.S. AIR FORCE

Orbital X-37B- anija kozmike
më e re dhe më e përparuar

Automjeti Testues Orbital X-37B, ose OTV, është një program testues eksperimental për të demonstruar teknologji për një platformë testimi hapësinor të besueshëm, të ripërdorshëm dhe pa pilot për Forcën Ajrore të SHBA. Objektivat kryesore të X-37B janë të dyfishta; teknologjitë e anijeve kozmike të ripërdorshme për të ardhmen e Amerikës në hapësirë dhe eksperimente operative të cilat mund të kthehen dhe të ekzaminohen në Tokë.

Automjeti Testues Orbital X-37B është anija kozmike më e re dhe më e përparuar. Bazuar në modelin X-37 të NASA-s, OTV pa pilot është projektuar për nisje vertikale në lartësi të ulta të orbitës së Tokës ku mund të kryejë eksperimentime dhe testime të teknologjisë hapësinore me kohëzgjatje të gjatë. Pas komandës nga toka, OTV hyn përsëri në mënyrë autonome në atmosferë, zbret dhe zbret horizontalisht në një pistë. X-37B është automjeti i parë që nga Shuttle Orbiter i NASA-s me aftësinë për të kthyer eksperimentet në Tokë për inspektim dhe analizë të mëtejshme, por me një kohë në orbitë prej 270 ditë ose më shumë, X-37B mund të qëndrojë në hapësirë për shumë më gjatë. Teknologjitë që testohen në program përfshijnë udhëzime të avancuara, lundrim dhe kontroll, sisteme të mbrojtjes termike, avionikë, struktura dhe vula me temperaturë të lartë, izolim konformal i ripërdorshëm, sisteme të lehta elektromekanike të fluturimit, sisteme të përparuara të shtytjes, materiale të përparuara dhe fluturim orbital autonom, rikthim dhe ulje.

Departamenti i Zyrës së Aftësive të Shpejta të Forcave Ajrore po udhëheq nisimën e Automjetit Testues Orbital



të Departamentit të Mbrojtjes, nga drejtimi i nën sekretarit të mbrojtjes për blerje, teknologji dhe logjistikë dhe sekretarit të Forcave Ajrore. Përpjekja e Forcave Ajrore OTV përdor investime të gjëra kontraktuese dhe qeveritare në programin X-37 nga Forcat Ajrore,

NASA dhe Agjencia e Projekteve të Avancuara të Mbrojtjes së Mbrojtjes për të vazhduar zhvillimin në shkallë të plotë dhe testimin në orbitë të një automjeti hapësinor me kohë të gjatë, të ripërdorshme. Programi origjinal X-37 i NASA-s filloi në 1999 dhe u transferua në DARPA

në 2004. NASA parashikoi ndërtimin e dy automjeteve, një Automjet Testimi të Përqasjes dhe Uljes, ose ALTV, dhe një Automjet Orbital. DARPA përfundoi pjesën ALTV të programit X-37 në 2006, duke ekzekutuar një seri provash të kryerjes së robërve

dhe fluturimeve falas. DARPA vërtetoi me sukses dinamikën e fluturimit dhe zgjati zarfin e fluturimit përtej provave me shpejtësi të ulët / lartësi të ulët të kryera më parë nga NASA në X-40A, një version nën-shkallë i X-37 i zhvilluar nga Laboratorët Kërkimorë të Forcave Ajrore. Automjeti Orbital i NASA-s X-37 nuk u ndërtua kurrë, por modeli i tij ishte pika fillestare për programin e Automjetit Testues Orbital X-37B të Forcave Ajrore.

Forcat Ajrore kanë fluturuar me sukses pesë misione X-37B, OTV-1 përmes OTV-5. Të pesë misionet e nisura nga Stacioni i Forcave Ajrore Cape Canaveral, Fla., Duke filluar me lëshimin e tij të parë në 22 Prill 2010. OTV-1 përmes OTV-3 të gjithë zbarkuan në Bazën e Forcave Ajrore Vandenberg, Kaliforni, ndërsa OTV-4 dhe OTV-5 u ulën në Qendrën Hapësinore Kennedy, Fla. Përmes pesë misioneve të përfunduara, X-37B ka kaluar një total prej 2,865 ditësh në orbitë, duke kontrolluar me sukses fluturimin, ri-hyrjen dhe uljen e teknologjive të X-37B si dhe eksperimentet operative për të përfutur nga komuniteti kombëtar hapësinor. Misioni aktual, OTV-6, u nis në 17 maj, 2020 nga Kepi Canaveral në një Atlas V.

OBM: Pas nxehtësisë
historike, uragane dhe
zjarre record

Pellgu i Oqeanit Atlantik po sheh një sezon rekord uraganësh, ndërsa bregu perëndimor i SHBA-së po lufton me zjarret më të mëdha të para deri më tani, ndërkohë që hemisfera veriore po i jep fund një periudhe nxehtësie historike, sipas agjencisë meteorologjike të OKB-së. "Temperaturat në periudhën tremujore midis qershorit dhe gushtit vendosën një rekord të ri veror në hemisferën veriore", njoftoi Organizata Botërore Meteorologjike (OBM).

"Ndërkohë, temperatura globale në të njëjtën periudhë ishte 0,92 gradë mbi mesataren e shekullit të XX, duke e bërë atë periudhën e tretë më të nxehtë të regjistruar", shtoi agjencia, duke cituar statistikat e SHBA. Gjashtë nga zjarret më të mëdha të regjistruara ndonjëherë në Kaliforni kanë ndodhur këtë vit, midis të cilëve zjarri më i madh deri më tani, që përfshiu gati 3 200 kilometra katrorë që nga gushti. Ndërkohë, prania e pesë cikloneve tropikale mbi Oqeanin Atlantik, këtë javë, vuri rekordin për numrin më të lartë të stuhive të tilla të njëhershme në rajon.

Kina dërgon nëntë
satelitë në hapësirë

Kina dërgoi të paktën nëntë satelitë në hapësirë, theksuan mediet zyrtare. "Satelitët nga grupi Jilin-1 Gaofen 03-1 u ngritën nga Deti i Verdhë në orën 09:23", njoftoi Xinhua News. Një raketë bartëse "Long Mars-11" u projektua për lëshimin, që është i pari nga deti. Javën e kaluar, Kina dërgoi një satelit vëzhgimi, Gaofen-11 02, në orbitë përmes një rakete transportuese "Long March-4B". Me punën e saj të zgjeruar hapësinore, duke përfshirë lëshimin e satelitëve, Kina është më afër përfundimit të stacionit të saj hapësinore.

ASTRONOMI- Në
recetën e lëndës së errët
mungon një përbërës

Mund të ketë një përbërës që mungon në recetën e lëndës së errët, një përbërës misterioz që zë 25% të universit, sipas hulumtimit të botuar në "Science" nga astrofizikanët italianë të Observatorit të Bolonjës të Institutit Kombëtar të Astrofizikës (INAF). "Ka një mospërputhje të papritur midis vëzhgimeve dhe modeleve teorike, që parashikojnë sesi lënda e errët duhet të shpërndahet në grupe galaktikash", vlerësuan ata. Falë të dhënave të mbledhura me Teleskopin Hapësinor Hubble të NASA-s, Agjencinë Europiane të Hapësirës (ESA) dhe Teleskopin e Observatorit të Europës Jugore (ESO) në Kili, astronomët kanë zbuluar një detaj shqetësues në mënyrën me të cilën sillen lënda e errët. Ata gjetën përqendrime të vogla dhe të dendura të saj, që e përthejnë dhe e zmadhojnë dritën shumë më intensivisht nga sa pritej. Si rezultat, disa përbërës mund të mungojnë në "recetat" aktuale, që përshkruajnë lëndën e errët, sepse ajo nuk lëshon, thith ose pasqyron dritë. Prania e saj njihet vetëm përmes tërheqjes së saj gravitacionale mbi lëndën e dukshme.





MINISTRJA E MBROJTJES OLTA XHAÇKA:

Angazhimi i FA nga toka e ajri të pakursyer për shuarjen e zjarreve

“Flakët e shkaktuara nga dora e njeriut më shumë sesa nga temperaturat e larta, kanë prekur sipërfaqe të tëra me pyja e kullota në 8 qarqe të vendit. Dhjetra efektivë të Forcave të Armatosura, të pajisur me mjetet e veshjet e posaçme kundër zjarreve janë angazhuar në disa operacione në Fier, Shkodër, Vlorë, Tiranë, Lezhë etj, ditë e natë, për shuarjen e zjarreve që famtërisht nuk kanë cënuar sigurinë e banorëve në këto zona. Angazhimi i FA nga toka e ajri do të jetë i pakursyer në të gjitha rastet kur, sipas ligjit, pushteti vendor ka ezauruar të gjithë kapacitetin me njerëz e mjete”, shkruan Ministria Xhaçka në facebook.

“Ligji “Për mbrojtjen Civile”, të cilin e kemi miratuar një vit më parë e që përben një prej elementëve më të rëndësishëm të reformës në fushën e emergjencave civile, nuk kursen as pushtetin vendor në rast se nuk i përgjigjet situatave të emergjencës, por as individët që i vënë zjarrin kullotave e pyjave, duke shkaktuar miliona lekë dëm të pasurisë kombëtare”, deklaron Ministria Xhaçka.

